



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

TEZA E DISERTACIONIT

**“Roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e
institucioneve shtetërore në Kosovë pas pavarësisë”**

Kandidati:

Bujar Daki

Mentori:

Prof. Dr. Jonuz Abdullahi

2019

ABSTRAKT

Që nga pavarësia e këndej, Republika e Kosovës është ballafaquar me sfidën e ndërtimit të institucioneve shtetërore, që nënkupton parapërgatitjet për formimin e institucioneve, krijimin e kushteve optimale për funksionimin e tyre në një mjedis të dalë nga lufta, duke pasur parasysh rregullimin e shtetit në suaza të njohjes ndërkombëtare dhe regulativës së re, duke mos mënjanuar këtu edhe zhvillimet politike që kanë ndodhur në Kosovë gjatë këtyre viteve.

Për më tepër, në shtet-ndërtimin e Kosovës nuk ka munguar edhe prezenca e faktorit ndërkombëtar, të cilët në mënyrë të vazhdueshme e kanë ndihmuar këtë proces, duke ofruar modele dhe trajnime të ndryshme, mbikëqyrje dhe këshilla, të cilat në masë të madhe kanë kontribuar në themelimin e institucioneve të shëndosha dhe funksionale.

Për të arritur në mënyrë sa më mirë prezantimin dhe sqarimin e kësaj teme, do të përdorim metodologji dhe teknika të ndryshme të hulumtimit, me anë të së cilave do të dëshmojmë supozimet dhe gjetjet të dala nga ky hulumtim. Metodatat të cilat do të përdoren ngërthejnë ato të analizës së teksteve, akteve dhe dokumenteve të publikuara, metodën krahasuese dhe empirike, ndërsa nuk do të mungojnë edhe teknikat ndihmëse të hulumtimit, siç janë anketa me qytetarë të Kosovës dhe intervista me personalitete të shquara të cilët kanë njohuri mbi temën në fjalë dhe me ekspertizën e tyre do të kontribuojnë në kompletimin e këtij hulumtimi.

Fjalët kyçe: Pavarësia, Kosova, shtet-ndërtimi, faktori ndërkombëtar, tranzicion

ABSTRACT

Since its independence, the Republic of Kosovo has faced the challenge of building state institutions, which means preparing for the establishment of institutions, creating optimal conditions for their functioning in a post-war environment, given state regulation in the country in the framework of international recognition and the new regulation, not excluding here the political developments that have taken place in Kosovo during these years.

Moreover, in the state-building of Kosovo there has also been evident the presence of the international community who have continuously assisted this process by providing various models and training, supervision and advice, which have largely contributed to the establishment of sound and functioning institutions.

In order to better present and clarify this topic, we will use different research methodologies and techniques, whereby we will prove the assumptions and findings from this research. The methods to be used include the analysis of published texts, acts and documents, the comparative and empirical method, and assistive research techniques, such as surveys with Kosovo citizens and interviews with prominent personalities, who are familiar with the topic and with their expertise will contribute to the completion of this research.

Keywords: Independence, Kosovo, state-building, international community, transition

STRUKTURA E PUNIMIT

Contents

ABSTRAKT	2
ABSTRACT.....	3
STRUKTURA E PUNIMIT	4
LISTA E SHKURTESAVE.....	6
LISTA E TABELAVE.....	7
LISTA E FIGURAVE.....	8
LISTA E GRAFIKONEVE	9
HYRJE	11
KAPITULLI – I	16
Ndryshimet politike në Evropën qendrore dhe lindore pas rrëzimit të murit të Berlinit dhe reflektimi i saj në Ballkanin Perëndimor	16
KAPITULLI - II.....	24
Lufta e Kosovës për pavarësi dhe intervenimi ndërkombëtar.....	24
Ndërhyrja ndërkombëtare dhe Marrëveshja e Ramboje-së.....	27
KAPITULLI - III	30
Krijimi i institucioneve të para të Kosovës së pasluftës dhe pavarësia.....	30
KAPITULLI – IV	42
Ndërtimi i institucioneve shtetërore pas pavarësisë dhe orientimi i politikbërrjes në Kosovë në frymën pro-perëndimore	42
KAPITULLI – V	46
Roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve shtetformuese në Kosovë	46
KAPITULLI – VI	62
Roli i shoqërisë civile në demokratizimin e shoqërisë dhe kualitetin e shërbimeve publike	62
Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi i realizuar (intervista dhe anketa).	75
Intervista	75
Intervista 1: Safet Gerxhaliu	75
Intervista 2: Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, ish President i Republikës së Kosovës	79
Intervista 3: Hajredin Kuçi.....	82

Intervista 4: Jakup Krasniqi	85
Intervista 5: Prof. Dr. Arsim Bajrami.....	88
Intervista 6: Prof. Dr. Ylber Sela	90
Intervista 7: Nazmi Maliqi	92
Konkluzione për intervistat e realizuara	97
Rezultatet e anketës.....	99
KONSTATIME DHE REKOMANDIME	135
LITERATURA E PËRDORUR.....	137
SHTOJCA.....	140
Pyetësor i anketës.....	140
Pyetjet e intervistës	146

LISTA E SHKURTESAVE

BE - Bashkimi Evropian

EULEX - Misioni i Unionit Evropian në Kosovë për Sundim të Ligjit

GNK - Grupi Ndërkombëtar i Krizave

HRW - Mbikëqyrja e të Drejtave të Njeriut

KB - Kombet e Bashkuara

KFOR - Forca e NATO-s në Kosovë

KIPRED - Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

NATO - Organizata e Traktatit Veriatlantik

OJQ - Organizatë Joqeveritare

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

RSFJ - Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNDP - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNHCR - Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara

UNMIK - Misioni i Përkohshëm Administrativ në Kosovë i Kombeve të Bashkuara

USAID - Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

LISTA E TABELAVE

No table of figures entries found.

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Qëllimi i strategjisë për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018	58
Figura 2. Përmirësimi i sundimit të ligjit - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018.....	59
Figura 3. Rritja e investimeve dhe i punësimit në sektorin privat - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018	60
Figura 4. Forcimi i kapitalit njerëzor - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018	61

LISTA E GRAFIKONEVE

No table of figures entries found.

FALËNDERIM

Gjatë kompletimit të hulumtimit të doktoraturës, grumbullimit të materialit, realizimit të pyetësorit dhe intervistave me personalitetet e shquara të shoqërisë Kosovare, jamë ndeshur me shumë sfida dhe vështirësi, të cilat kam arritur t'i tejkaloj me ndihmën e miqve dhe familjarëve të mij. Për atë shkak, dua të falemnderoj gjithsecilin që ka kontribuar në përgaditjen e këtij hulumtimi, duke theksuar mentori im, Prof.Dr. Jonuz Abdullai, dhe familjen time, e cila gjatë tërë kohës më ka dhënë përkrahje maksimale.

Bujar Daki

HYRJE

Ndryshimet socio-politike ndodhin në tërë globin, por ndryshimet gjatë periudhës së tranzicionit në shtetet postkomuniste dallojnë nga shteti në shtet. Këto ndryshime karakterizohen me shpërbërjen e sistemeve të mëparshme si ai i BRSS dhe formimi i shteteve të pavarura pa luftë në mënyrë paqësore, si që është rasti i shteteve Baltike dhe bashkimi i dy Gjermanive pas rrëzimit të murit të Berlinit. Për dalim nga ndryshimet që ndodhën në shtetet e Evropës qendrore, në shtet e Evropës juglindore, në veçanti në Ballkan, ndryshimet ishin të përcjella me konflikte dhe luftëra të përgjakura, si që ndodhi në Kroaci, Bosnjë, Serbi, Maqedoni dhe në fund në Kosovë. Këto luftëra sollën shumë viktima në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, por si rezultat i gjithë kësaj patëm formim të shteteve të reja dhe prezencë aktive të faktorit ndërkombëtar pa ndihmën e të cilit nuk do të kishim Bosnjën dhe Kosovën e pavarur. Zhvillimi i këtyre shteteve të Ballkanit perëndimor paraqet sfidë por edhe brengë për qytetarët dhe aleatët e tyre, që udhëheqësit e tyre mos merren me të kaluarën, por të shohin ardhmërinë duke u inkuadruar në rrjedhat e gjirit të familjes evropiane. Rekomandimet që vijnë nga çdo raport i komisionit evropian, kanë të bëjnë me një kërkesë për përmbushjen e obligimeve dhe kritereve për inkuadrimin e këtyre shteteve në UE dhe në NATO. Rekomandimet dhe përmbushja e kritereve për këto shtete janë të pa kapërcyeshme, sepse për ndryshe këto shtete do të jene jashtë agjendës së interesimit evropian dhe amerikan.¹

Që nga pavarësia e këndej, Republika e Kosovës është ballafaquar me sfidën e ndërtimit të institucioneve shtetërore, që nënkupton parapërgatitjet për formimin e institucioneve, krijimin e kushteve optimale për funksionimin e tyre në një mjedis të dalë nga lufta, duke pasur parasysh rregullimin e shtetit në suaza të njohjes ndërkombëtare dhe regulativës së re, duke mos mënjanuar këtu edhe zhvillimet politike që kanë ndodhur në Kosovë gjatë këtyre viteve. Për më tepër, në shtet-ndërtimin e Kosovës nuk ka munguar edhe prezenca e faktorit ndërkombëtar, të cilët në mënyrë të vazhdueshme e kanë ndihmuar këtë proces, duke ofruar modele dhe trajnime të ndryshme, mbikëqyrje dhe këshilla, të cilat në masë të madhe kanë kontribuar në themelimin e institucioneve të shëndosha dhe funksionale.

¹ Jonuz Abdullai, "Politika dhe politikat publike". Arbëria Design, 2016, Tetovë, f. 142

Për më tepër, procesi i politikbërjes në shtetet e reja siç është Kosova do të jetë preokupimi kryesor që do të shtjellohet në këtë hulumtim shkencor, gjithnjë duke u bazuar kryesisht në teorinë e Francis Fukujamës mbi ndërtimin e shtetit dhe institucioneve shtetërore, por edhe të studijusve tjerë vendor dhe atyre ndërkombëtar. Duke qenë të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm të kësaj fushe në studimin e zhvillimeve konkrete politike në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, do të bëhet një studim komparativ si dhe krahasime tjera me shtetet e Ballkanit perëndimor, ku roli i faktorit ndërkombëtar ndryshon.

Në anën tjetër, me konceptin qasje shkencore kuptohet bashkërendimi i metodave, teorive dhe teknikave tjera të cilat përdoren për studimin e rastit të Kosovës. Por qasja shkencore përfshinë edhe mënyrën se si këto teori e shpjegojnë rastin, pastaj të cilit lloj janë ato, me çfarë logjike shkencore i qasen studimit, etj. Gjithashtu në qasjen shkencore paraqitet përdorimi i të gjitha teknikave, metodave dhe teorive, që e bëjnë të mundur një të kuptuar në detaje të rastit.

Studimi i rastit të Kosovës është bërë në kontekst të caktuar kohorë dhe përmbajtësorë. Kosova si rast për studim është marrë në kontekstin kohorë 2008-2017, që është interval në të cilin kanë ndodhur zhvillimet politike më dinamike në fushën e shtetëndërtimit. Andaj, ky interval përbën mostër të mirë kohore për një studim të rastit. Natyrisht se periudha para këtij intervali e ka ndikuar kontekstin kohorë të veçuar nga ne, dhe se gjithashtu ky interval i veçuar, i ka determinuar zhvillimet politike dhe shoqërore deri më sot. Por, periudha paraprake e zhvillimeve politike në vend dhe në rajon do të analizohet për të dhënë informata dhe sigurimin e të dhënave për të bërë një analizë kualitative me çrast do të arrijmë në rezultatet e kërkuara.

Lëndë e kërkimit në këtë hulumtim shkencor do të jetë mënyra e formimit të institucioneve shtetërore në Kosovë pas intervenimit të NATO-s, gjatë periudhës së tranzicionit dhe pas shpalljes së pavarësisë. Në këtë kontekst do të hulumtohen mënyra e ndikimit të faktorit ndërkombëtar duke filluar që nga vendosja e kornizës ligjore dhe kushtetuese në rrafshin ndërkombëtar dhe në atë lokal, me themelimin e institucioneve vëzhguese ndërkombëtare dhe me ndërtimin e institucioneve në shtetin e Kosovës. Gjatë kësaj do të shtjellohen format dhe mënyrat e ndikimit të faktorit ndërkombëtar në nivelin profesional, i cili kryesisht ka qenë në formë të dhënies së ekspertizës dhe përvojave të mira, por edhe me financimin e këtyre projekteve përmes granteve dhe ndihmave financiare me qëllim të formimit të institucioneve kredibile dhe të pavarura.

Me rëndësi të veçantë do të jetë edhe procesi i njohjes të shtetit të Kosovës si dhe përkrahja ndërkombëtare në këtë aspekt. Kjo për arsye se ndikimi në rrafshin ndërkombëtar në formimin e institucioneve shtetërore është tejet i madh, gjë e cila përbën edhe njërin nga fokuset kryesore të hulumtimit tonë. Rëndësi të veçantë do t'i përkushtohet edhe sektorit joqeveritar, si një nga kontrollorët dhe ndihmësit në krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore të përgjegjshme dhe llogaridhënëse. Gjithashtu nuk do të mungojë edhe roli dhe perceptimi i qytetarëve me çrast edhe do të grumbullohen të dhëna nga hulumtimet paraprake si dhe do të bëhet analiza e këtyre të dhënave.

Arsyeja e përzgjedhjes së rastit të Kosovës për studim, është bërë përshkak se nuk ka shumë studime paraprake për këtë drejtim, d.m.th. se nuk ka pasur një mori studimesh variable në mënyra të ndryshme, për çka tek ne do të zgjojë shumë interes. Njëherit, arsyeja e studimit të rastit të Kosovës në fushën e shtetndërtimit koinçidon edhe me nevojën imediate për të pasur një studim të thellë edhe në gjuhën shqipe, i cili mund të jep kontributin e vet shkencor duke e trajtuar rëndësinë e faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e institucioneve shtetërore në Kosovë.

Hulumtimi në fjalë për nga ana përmbajtësore përbëhet nga hyrja, shtatë kapituj, konkluzioni, rekomandimet si dhe bibliografia, të gjitha këto të shkruara me një volum solid dhe me standarde të kërkuara për shkrimin e një teze të doktoratës.

Në hyrje ofrohet një pasqyrim konçiz në pika të shkurtëra për tërë problematikën që trajtohet në këtë tezë. Pastaj do të tregohet edhe për teknikat e hulumtimit me të cilat do të kryhet studimi.

Në pjesën e parë ceket një vështrim historik mbi ndryshimet politike dhe shoqërore në Evropën qendrore dhe jug-lindore. Prej kapitullit të dytë e më tutje flitet rreth institucioneve shtetërore dhe shtetndërtimit me rast të veçantë shtetin e Kosovës. Më pastaj bëhet shpalosja e intervistave anketës nga hulumtimi i realizuar. Në fund të hulumtimit japim konstatimet dhe rekomandimet.

Për nga aspekti metodologjik, si hipotezë kryesore në këtë hulumtim qëndron konstatimi se roli i faktorit ndërkombëtar në ndërtimin e institucioneve shtetërore të Kosovës është vendimtar dhe paraqet orientimin pro-perendimor të politikbërjes kosovare.

Ndersa si hipotezë ndihmese e kemi parashtruar konstatimet se:

- Përmes asistencës nderkombetare në Kosovë ndërtimi i institucioneve shtetërore realizohet me një dinamikë më të shpejtë.
- Roli i faktorit ndërkombëtar ndikon në harmonizimin e legjislacionit kosovar me atë European.

Në suazë të përpilimit të kësaj teze të disertacionit dhe gjithnjë për të arritur deri tek esenca e problematikës së parashtruar rendisim edhe pyetjet kërkimore përmes së cilave do të arrijmë deri tek gjetjet e dëshiruara të cilat do të rrumbullaksojnë hulumtimin tonë kërkimor:

1. A do të realizoheshte pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?
2. Në cilat segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?
3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës?
4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënese në Kosovën e pasluftës?
5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?
6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë?
7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparencia, llogaridhënia dhe shërbimet karshi fqinjëve të tyre?
8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?
9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Metodologjia e përdorur në këtë punim është zgjedhur me kujdes dhe është tipike për temën e lartëpërmendur. Nga kjo metodologji që do të përdorët këtu, kryesorja është metoda e analizës së përmbajtjes së teksteve, publikimeve dhe raporteve nga institucionet hulumtuese shkencore vendore dhe ndërkombëtare, analiza krahasuese, metoda historike dhe përshkruese, të cilat janë metoda që në detaje i përshtaten natyrës së këtij hulumtimi. Gjithashtu për të aritur rezultatet të

cilat na interesojnë, do të përdorim edhe teknikat ndihmëse siç janë intervista me zyrtarë dhe përfaqësues të shquar të cilat i japin në kontribut të veçantë këtij hulumtimi duke pasur parasysh përvojën e tyre në këtë fushë.

KAPITULLI – I

Ndryshimet politike në Evropën qendrore dhe lindore pas rrëzimit të murit të Berlinit dhe reflektimi i saj në Ballkanin Perëndimor

Përderisa në Evropën perëndimore dhe qendrore filloi bashkimi i shteteve në një union të vetin, në territorin e Ballkanit filloi lufta efektet e së cilës akoma ndjehen në këtë rajon. Tranzicioni i stërzgjatur dhe i vonuar akoma më tej e vështirëson rrugëtimin e rajonit në bllokun Veri-atlantik. Institucionet publike të politizuara, krimi i organizuar, mungesa e sundimit të ligjit dhe e lirisë së shprehjes janë vetëm disa nga shkaktarët kryesor të ngecjes në rafshin politik dhe ekonomik të shteteve të Ballkanit perëndimor.

Rënia e Murit të Berlinit zakonisht konsiderohet të jetë pika fillestare për ndryshimet e mëdha politike në Evropën qendrore dhe lindore, e cila më pastaj e shtriu efektin e saj edhe në ish-republikat sovjetike. Heqja e pengesave fizike dhe politike ndërmjet Berlinit lindor dhe atij perëndimor me të vërtetë ka luajtur një rol të madh dhe në shumë aspekte e bëri procesin e "çlirimit" të pakthyeshëm. Që nga fillimi i tij në vitin 1961, Muri i Berlinit u bë simboli më i fuqishëm i ndarjes së Perëndimit demokratik nga Lindja komuniste gjatë luftës së ftohtë. Rënia e murit më 9 nëntor 1989 hapi rrugën për bashkimin e Gjermanisë dhe çlirimin e vendeve të Evropës Lindore të lidhura nën aleancën e Paktit të Varshavës. Në dhjetor 1991, Bashkimi Sovjetik u shpërnda në pesëmbëdhjetë republika të pavarura, nga të cilat Federata Ruse ishte më e madhe. Më 1 janar 1993, Çekosllovakia u nda në dy vende të ndara, Republika Çeke dhe Sllovakia. Shkëputja e Jugosllavisë në vitin 1991 kreu një sërë luftërave nga viti 1991 deri në vitin 1999 që rifilloi spastrimin etnik dhe gjenocidin në kontinentin evropian. Përfundimisht, Sllovenia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova të gjithë do të bëhen shtete të pavarura. Ngjarjet që u zhvilluan pas rënies së Murit të Berlinit ndikuan pothuajse në gjithë territoret e Evropës qendrore dhe juglindore. Mund të themi se rrënimi i Murit të Berlinit dhe proceset që filluan të ndodhnin atje, patën efektin domino për të gjitha

vendet që pas Luftës së Dytë botërore kishin instaluar sistemin monist partiak dhe sistemin socialist politik.²

Fryma e ngjarjeve të asaj kohe e kaploi edhe federatën Jugosllave e cila ishte një krijesë artificiale e lindur në Konferencën e AVNOJ-it, e që përbëhej prej 6 republikave dhe dy krahinave autonome në kuadër të Republikës së Serbisë, por që ishin pjesë konstituive e federatës Jugosllave.³ Funksionimi i kësaj krijese mundë të thuhet se pati sukses në ekzistimin e saj, edhe se në brendi kishte mos pajtime të theksuara, ndërmjet republikave e sidomos atyre Sllovene e Kroate me atë të Serbisë, e posaçërisht ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që është cilësuar si një armiqësi historike. Mirëpo, nën udhëheqjen e Titos, derisa ai ishte gjallë, këto mospajtime edhe pse ndonjëherë dilnin në sipërfaqe, me politikën e tij e ndonjëherë edhe me dorë të fortë, arrinte ti zhdukte nga sipërfaqja edhe pse në brendi ato vazhdonin të ekzistonin.

Kjo zgjati për gati 50 vite edhe pse pas vdekjes së Titos me 1980 u lëkundën fort themelet e federatës. Pas disa tentimeve për të vazhduar si tërësi kjo federatë, e iniciuar nga Republika e Serbisë, ku ata tentonin që përmes hegjemonisë së tyre të marrin rolin udhëheqës të shtetit, të cilin e kishin synuar gjithnjë dhe vazhdimin të ekzistimit të Jugosllavisë si një konfederate, e sponzoruar nga Sllovenët dhe Kroatët, e që gjithashtu dështoi pasi që serbët nuk pranonin një organizim konfederal, definitivisht filloi zhbërja e kësaj krijese e ashtuquajtur Jugosllavi. Tragjedia e ndarjes së republikave e posaçërisht të atyre Kroate dhe Bosnjës e Hercegovinës e lëkundti fortë ndërgjegjen njerëzore, ku popujt e ish Jugosllavisë përjetuan masakrat më të mëdha që prej Luftës së Dytë botërore. Çuditërisht fati i shkëputjes së Republikës së Maqedonisë ishte krejtësisht ndryshe, arsyen nuk di a e ka studiuar ndokush që të dal me një hulumtim që si ishte e mundur që Republika e Maqedonisë të mos përfshihet në këto luftëra që i inicioi pushteti i fqinjit të saj verior, e që është përgjegjësi kryesor për të gjitha ato mizori që përjetuan popujt e ish Jugosllavisë. Fatin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sa i përket pavarësimit nga Jugosllavia siç e kemi parë, nuk e patën edhe republikat tjera që ju imponua një luftë e përgjakshme të cilën e përjetuan popujt e tyre, e posaçërisht Republika e Bosnës dhe

² Editors, History.com. "Berlin Wall." *History.com*, A&E Television Networks, 15 Dec. 2009, <https://www.history.com/topics/cold-war/berlin-wall>

³ "The Breakup of Yugoslavia, 1990–1992." *U.S. Department of State*, Office of the Historian Bureau of Public Affairs United States Department of State, <https://history.state.gov/milestones/1989-1992/breakup-yugoslavia>

Hercegovinës dhe ajo e Kroacisë. Derisa Republika e Sllovenisë përjetoi ashtu të themi një luftë dhjetë ditësh gjatë të cilës humbën jetën gjashtëdhjetë e gjashtë njerëz nga të dyja anët. Sikurse për arsyet që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë, ashtu edhe për datën e këtij procesi nuk ekziston një konsensus i fortë. Në kuptimin formal mund të thuhet se shpërbërja ka filluar me shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Republikave të Sllovenisë dhe Kroacisë me 24.06.1991, ndërsa kjo shpërbërje përfundoi me formimin e shtetit të përbashkët të Serbisë dhe Malit të Zi në Prill të vitit 1992. Derisa ka prej tyre që mendojnë se ky proces ka filluar qysh me aprovimin e kushtetutës së 1974-ës e cila ka krijuar Jugosllavinë në federatë me elemente të konfederatës që nënkupton predispozitat e ndarjes. Disa të tjerë mendojnë se shkak kryesorë janë ndryshimet kushtetuese të Serbisë, me të cilat u është suprimuar autonomia e krahinave të Kosovës dhe Vojvodinës, e që qoi deri te kriza kushtetuese në nivelin federal. Edhe pse shpërtheu lufta në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ka prej atyre që shpërbërjen e Jugosllavisë e lidhin me marrëveshjen e paqes së Dejtonit të mbajtur më 1995, ku me këtë rast bëhet edhe formalizimi i ndarjes.⁴ Disa të tjerë mendojnë se edhe pas kësaj date ka vazhduar shpërbërja e Jugosllavisë deri në kohën kur u nda bashkësia shtetërore e Malit të Zi dhe Serbisë, gjegjësisht krijimi i shteteve të pavarura të Malit të zi dhe Serbisë në 2006-të.

Vlen të theksohet se rol kyç në zgjimin e nacionalizmit serb, edhe pse ai gjatë gjithë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë në një farë forme ka qenë aktiv, ka luajtur edhe memorandum i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Ky memorandum shpreh se populli serb është i rrezikuar nga gjenocidi në Kosovë dhe se serbët janë të diskriminuar në Jugosllavi. Sipas akademikëve serb ky problem nuk mund të zgjidhet deri sa të mos arrihet bashkimi i plotë nacional dhe kulturor i gjithë popullit serb pavarësisht trojeve ku jetojnë ata.⁵ Një ditë pas shpalljes së këtij memorandum, kryetari i Serbisë Petar Stambulliq e gjykoji si një thirrje për luftë. Që atëherë fillon bashkimi i nacionalistëve serb nga të gjitha sferat e jetës shoqërore rreth kryenacionalistit Slobodan Millosheviq, e që Stambulliqit i kushtoi me largim nga pozita si dhe me vdekje tragjike.⁶

⁴ Europe | Timeline: Break-up of Yugoslavia. *BBC News*, BBC, 22 May 2006, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4997380.stm>

⁵ "The Breakup of Yugoslavia, 1990–1992." *U.S. Department of State*, Office of the Historian Bureau of Public Affairs United States Department of State, <https://history.state.gov/milestones/1989-1992/breakup-yugoslavia>

⁶ Hasani, Enver, "Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova" Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2000

Ngritja dhe fuqizimi i nacionalizmit serb në Serbi dhe faktorizimi i Slllobodan Millosheviqit në Lidhjen Komuniste fillimisht, e pastaj edhe në të gjitha institucionet shtetërore, rezultoi që serbët ku do që ishin në trojet e Jugosllavisë të paraqesin ankesat e tyre që gjoja janë të diskriminuara, e me këtë shkak edhe mundësinë që udhëheqësit serb nën ndikimin e Millosheviqit të marrin rolin e “kujdestarit” të popullit serb kudo që ai jeton. Kjo filloi në Fushë Kosovë me daljen haptas në mbrojtje të nacionalistëve serb e vazhdoi në të gjitha pjesët e Jugosllavisë. Këto veprime ndikuan që edhe në Slloveni e Kroaci të krijohen parti me elemente nacionale që arritën të grumbullojnë numër të madh të përkrahësve të tyre. Kështu që në zgjedhjet e para të mbajtura në Slloveni, partia komuniste humbi dhe pushtetin e fitoi DEMOS, derisa në Kroaci HDZ, parti që grumbulloi nacionalistët Kroat të rrethuar rreth Franjo Tugjman-it, gjithashtu e mundi partinë komuniste. Ardhja e Tugjman-it në krye të republikës së Kroacisë dhe Stipe Mesiq në krye të qeverisë Kroate, tek serbet e Kroacisë ngjalli pakënaqësi të mëdha si dhe reaksione të ndryshme, që rezultoi me një luftë të përgjakshme.⁷

Në Bosnjë dhe Hercegovinë fitues të zgjedhjeve ishte koalicioni i partive nacionaliste muslimane SDA, serbe SDS dhe kroate HDZ për BH. Në Maqedoni numrin më të madh të vendeve e fitoi partia partia nacionaliste e maqedonëve VMRO-DPMNE, mirëpo pushtetin e mori koalicioni i socialistëve të reformuar dhe liberalëve pro Markoviqit.⁸ Në Serbi dhe Mal të Zi fitore arritën partitë pro Millosheviqiane SPS dhe DPSCZ. Në Kosovë grupacioni më i madh politik në kushtet e patronizimit të Serbisë LDK-ja në mesin e subjekteve politike të tjera si Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demokristiane, Partia Fshatare, etj. Deri më 1996, kur veç Jugosllavia po shpërbëhej dhe sistemi komunist po rrënohej, në Kosovë qenë shfaqur dhe organizuar 15 parti të ndryshme politike.⁹

Sa i përket Shqipërisë pluralizmi politik fillon me themelimin e partisë së parë asaj Demokratike, e spektrit të djathë, pastaj në 1991 e më tej krijohen edhe parti të tjera si ajo Republikane, Socialdemokrate, Socialiste, etj. Mirëpo, në zgjedhjet e Marsit të 1991 Ramiz Alija dhe Partia Komuniste fituan sërish. Derisa, në Mars të vitit 1992 zgjedhjet i fitoi opozita anti-komuniste e udhëhequr nga Partia Demokratike. Ramiz Alia dha dorëheqje nga presidenti i

⁷ Glenny, Misha. “The Massacre of Yugoslavia.” *The New York Review of Books*, The New York Review of Books, 30 Jan. 1992, <https://www.nybooks.com/articles/1992/01/30/the-massacre-of-yugoslavia/>

⁸ Europe | Timeline: Break-up of Yugoslavia. *BBC News*, BBC, 22 May 2006, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4997380.stm>

⁹ Hasani, Enver, “Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova” Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë 2000

vendit dhe u pasua nga Sali Berisha e që prej kohës së para diktaturës u bë lideri i parë demokratik i Shqipërisë.¹⁰

Pas rënies së murit të Berlinit dhe përhapjes së një fryme demokratike, anti-komuniste në Evropën qendrore dhe juglindore, u krijuan kushte për një pluralizëm politik edhe pse me pasoja të mëdha për popullatën e cila ju priu këtyre ndryshimeve përmes revoltave, demonstratave e edhe me luftëra të përgjakshme, si në rastin e Jugosllavisë. Në shumicën e këtyre vendeve që prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ishte hera e parë që po organizoheshin zgjedhje të lira demokratike pluraliste. Këto parti grumbullonin rreth tyre forcat demokratike që ishin të ngulfatur nga sistemi monist. Në republikat e ish Jugosllavisë e cila po rrënohej së bashku me sistemin politik, partitë politike ishin kryesisht të përbëra në bazë nacionale, ku pjesëtarët e këtyre partive grumbulloheshin për të realizuar të drejtat e tyre nacionale e që për qëllim kryesor kishin pavarësimin nga ajo krijesë artificiale që për gjysmë shekulli funksionoi nën presionin që një ditë do të shpërbëhet.¹¹

Edhe pse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga këto ndryshime që i përfshinë këto vende të Evropës, ende mungon një funksionim i mirëfilltë i këtyre grupimeve politike, që elektorali të bashkohet rreth ideve dhe programeve të këtyre partive, e jo rreth liderit apo një grupi individësh me influencë, çfarë do qoftë ajo apo edhe rreth bindjeve nacionaliste, siç kemi edhe rastin edhe sot posaçërisht në Ballkanin perëndimorë.

Pothuajse shumica e shteteve të Evropës qendrore dhe juglindore të dala nga blloku ish-sovjetik si dhe ato të Ballkanit perëndimorë që u formuan pas shpërbërjes së Jugosllavisë ende janë në fazën e tranzicionit ku me vështirësi të mëdha po mundohen t'i tejkalojnë ndikimet konceptuale të trashëguara nga një sistem monist që mbizotëroi për 50 vite. Edhe pse disa republika të ish Jugosllavisë përmes ndihmës që i ofruan Bashkimi Evropian dhe organizatat e ndryshme që funksionojnë në kuadër të këtij unioni për demokratizimin e institucioneve shtetërore-administrative si dhe të grupimeve politike për organizimin e zgjedhjeve të lira, arritën të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, sërish janë akoma larg krahasimit me vendet tjera që

¹⁰ “Ngjarjet e pas vitit 1990, që çuan në zgjedhjet e parakohshme pluraliste të 31 Marsit 1991.” *Agjencia e Lajmeve SOT NEWS*, 1 Apr. 2013, <https://sot.com.al/dossier/ngjarjet-e-pas-vitit-1990-qe-çuan-në-zgjedhjet-e-parakohshme-pluraliste-të-31-marsit-1991>

¹¹ Po aty

kanë një demokraci të mirëfilltë. Edhe shtetet tjera të rajonit pothuajse vuajnë nga i njëjti sindrom sa i përket parimeve demokratike, megjithëse gjatë gjithë kohës proklamojnë se janë të orientimit Euro-Atlantik. Mirëpo, assesi nuk po munden të çrrënjisin veprimet që parandalojnë instalimin e një shteti ligjor pa ndikime politike në institucionet shtetërore dhe administratë publike, ta luftojnë krimin e organizuar, ndikimin në lirinë të shprehjes nëpër media e që ndikojnë në ngadalësimin e përmbushjes së reformave si në aspektin politik po ashtu edhe në atë ekonomik për anëtarësim në këto organizata Euro-Atlantike. Derisa partitë politike nuk reformohen në kuptimin organizativ, që të kenë një demokraci të brendshme ku çdo kush ka të drejtë të shpreh mendimin e lire, pavarësisht se a i pëlqen liderit apo jo, e mos të linçohet për atë mendim, ky tranzicion do të zgjatë edhe për një kohë.

Përvoja e vendeve me demokraci të përparuar tregon se demokracia dhe procesi demokratik është jetësor, organik dhe nuk ka një ditë kur mbaron. Demokracia është një proces i vazhdueshëm. Nëse demokracia është një proces dhe ende i pa arrirë nga shoqëri të cilat i referohemi si model, çfarë duhet të ndodh me demokracitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor? Nga të gjitha burimet e literaturës shkencore dhe përgjithësime praktike të vendeve me demokraci të përparuar, vërehet se përfaqësimi politik e qeverisës është larg interesave të të qeverisurve, të cilët i kanë votëbesuar dhe zgjedhur qeverisësit, ndërsa pothuajse në mënyrë masive ka mungesë besimi tek ata. Për arsyet e mësipërme, kërkohen të ndërtohen mekanizma, të cilat përfshijnë realisht shoqërinë në qeverisje dhe vendimmarrjet për mënyrën se si do të ndërtohet dhe zhvillohet e ardhmja e shoqërisë dhe qytetarëve në vendet e Ballkanit Perëndimor.¹²

Sistemet e reja politike e qeverisëse si edhe përfshirja në proceset e integritetit Euroatlantik krijojnë premisat dhe shanset për rritjen e shkallës së demokracisë pjesëmarrëse në jetën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas Friedman, Debra dhe Doug me Adam lëvizjet e reja sociale dhe rrjetet aktiviste mund të kontribuojnë ndjeshëm në përfshirjen në vendimmarrje të shoqërive në tranzicion, të cilat përjetojnë edhe ngarkesat e së kaluarës nacional-shoviniste. Mendësitë e reja të të gjitha moshave, por së pari të brezit të ri, të cilët nuk bartin gjurmë ngacmuese të së kaluarës, si edhe grupimeve profesionale të edukuar në vendet me demokraci të

¹² Reis Mulita, Të qeverisim Ballkanin perëndimor nëpërmjet opinionit të përbashkët public, Gjeopolitika, Tiranë 2015, f35

pjekur perëndimore, janë një mundësi e mirë mbi argumentin për të cilin po diskutojmë. Mbi rolin e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset e demokracisë pjesëmarrëse argumentojnë edhe Zimmer, Annette, Freise, Matthias. Aplikimi i demokracisë pjesëmarrëse nëpërmjet shoqërisë civile, është konsideruar si plotësuese ose vlerë shtesë për demokracinë përfaqësuese, e reflektuar edhe në politikat dhe programet e Bashkimit Evropian të tilla si Karta e Bardhë mbi Qeverisjen e BE(EC 2001) dhe draft Marrëveshja e Kushtetutës.¹³

Për të pasur një pasqyrë më ndryshe, ngjarjet që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë i tregojmë më poshtë sipas kronologjisë kohore:

- 1991 - Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina u shkëputën nga Jugosllavia dhe shpallen pavarësinë e tyre.
- 1992 - shpërthen lufta në Ballkan.
- Korrik 1995 - Ndodh gjenocidi i Srebrenicës. 8 000 boshnjakë të vrarë nga njësitë e Ushtrisë të Republikës Srpska nën komandën e gjeneralit Ratko Mladić.
- Dhjetor 1995 - Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia nënshkruajnë Paqen e Dejtonit, Marrëveshje për t'i dhënë fund luftës në Bosnje dhe Hercegovinë.
- 1998 Mars-Shtator 1998 - Konflikt i hapur midis policisë serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)
- Mars 1999 - Bisedimet e paqes të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht dështojnë dhe NATO fillon sulmet ajrore kundër Jugosllavisë, që zgjatën 78 ditë para se të dorëzohej Beogradi.
- Qershor 1999 - Presidenti Milošević pranon të tërheq trupat nga Kosova. NATO ndërpret goditjet nga ajëri.
- Shkurt 2003 - Milošević është hedhur në gjyq në Hagë me akuzat e krimeve të luftës në Kosovë, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë.
- Tetor 2003 - Bisedimet e para të drejtpërdrejta midis liderëve shqiptarë serbë dhe kosovarë që nga viti 1999.
- Qershor 2006 - Parlamenti i Malit të Zi shpalli pavarësinë e Malit të Zi nga Unioni Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi.

¹³ Reis Mulita, Të qeverisim Ballkanin përmjet opinionit të përbashkët public, Gjeopolitika, Tiranë 2015, f39

- Shkurt 2008 - Republika e Kosovës shpall pavarësinë. Serbia thotë se masa është e paligjshme, por fuqitë më të mëdha të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara njohin pavarësinë.¹⁴

¹⁴ Komisioni Evropian, 25 years after the fall of the Iron Curtain, The state of integration of East and West in the European Union, Publications Office of the European Union, 2014

KAPITULLI - II

Lufta e Kosovës për pavarësi dhe intervenimi ndërkombëtar

Lëvizjet dhe ndjenjat nacionaliste u përshkallëzuan midis serbëve si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, dhe midis shqiptarëve të Kosovës, në disa mënyra dhe në disa nivele. Rritja e Slobodan Milošević në fund të viteve 80 përforcoi tensionet midis Serbisë dhe Kosovës, pasi ai luajti mbi frikën e popujve kundër armikut të pretenduar dhe shfrytëzoi emocionet nacionaliste. Çështja e Kosovës u bë një mjet thelbësor për Millosheviqin për të përmirësuar fuqinë. Ai e revokoi statusin e tij autonom të Kosovës dhe e ktheu rregullin në Jugosllavi, e cila ishte një provokim i shkëlqyeshëm për shqiptarët e Kosovës.¹⁵ Shteti serb imponoi disa politika të diskriminimit etnik, të cilat përfshinin dëbimin e shqiptarëve të Kosovës nga pozita më të larta në administratën publike. Kjo rezultoi në krijimin e një shteti paralel në Kosovë, në vitet 1990, të kryesuar nga presidenti i zgjedhur hije Ibrahim Rugova. Ai aplikoi jo-dhunë si metodë për të arritur pretendimet e shqiptarëve të Kosovës, dhe si kundërshtim ndaj administratës serbe në Kosovë. Me gjithë përpjekjet për një qasje jo të dhunshme, një lëvizje guerile shqiptare doli në të njëjtën kohë në Kosovë, e ashtuquajtura Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Ata mbronin një alternative revolucionare ndaj rezistencës pasive. UÇK-ja kreu disa sulme të synuara ndaj policisë dhe forcave ushtarake serbe që u përgjigjën ashpër, me pasojën e shpërthimit të luftës në Kosovë në 1998.¹⁶

Më vitin 1989 shpërthyen demonstrata gjithëpopullore për ruajtjen dhe avancimin e autonomisë. Minatorët e Trepçës në shenjë protestë u ngujuan në zgafelle për dy javë rresht me kërkesën për ta mbrojtë pavarësinë e institucioneve të Kosovës dhe për ta shqyrtuar fatin e Kosovës në OKB. Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës, i rrethuar me tanke, dha pëlqimin për ndryshimin e kushtetutës. Gjatë manifestimeve kundër ndryshimit të kushtetutës, ranë 30 dëshmorë. U izoluan 254 intelektualë dhe kuadro udhëheqëse shqiptare. Një formë shumë e rëndë e represionit policor serb ishte edhe helmimi i 7 mijë nxënësve shqiptarë. Inteligjenca shqiptare më 23 dhjetor 1989 themeloi Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), e cila, nën

¹⁵ Judah, Tim, 2000. Kosovo: War and Revenge, London: Yale University Press

¹⁶ Guzina, Dejan, 2003. "Kosovo or Kosova – Could It Be Both? The Case of Interlocking Serbian and Albanian Nationalism" in Bieber, Florian –Daskalovski, Židas, (eds.), Understanding the War in Kosovo, London: Frank Cass Publisher

udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, angazhohej për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve në Jugosllavi në bazë të parimit të vetëvendosjes. Më pas u formuan edhe parti të tjera dhe Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në ish-Jugosllavi, që mbështeste Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, mbështeste kërkesën e shqiptarëve në Maqedoni për të qenë element shtetformues, ndërkaj për shqiptarët në Luginën e Preshevës kërkonte autonomi në shkallë të lartë me të drejtë bashkimi me Kosovën. Me qëllim të homogjenizimit të popullit shqiptar nisi pajtimi i gjaqeve, ku u falën mbi 1.200 gjaqe.¹⁷

Më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës e shpalli Deklaratën Kushtetuese mbi pavarësinë dhe barazinë e Kosovës në Jugosllavi. Më 7 shtator 1990 u miratua Kushtetuta e Kosovës. Në shtator 1991 u mbajt referendumi për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet parlamentare e presidenciale. Pushteti serb dëboi nxënësit dhe studentët shqiptarë nga shkollat dhe fakultetet, por shqiptarët organizuan sistemin e pavarur të arsimit në shtëpi-shkolla. Po ashtu, pushteti serb dëboi nga puna mijëra shqiptarë, shumë prej tyre u detyruan të emigronin. Shqiptarët, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, e bindën botën se e donin lirinë. Bota u bind se Kosova e meriton lirinë. Represioni serb ndikoi që më 1 tetor 1997 të shpërthejnë protestat e popullsisë dhe të studentëve të UP-së kundër pushtetit okupues. Ushtria dhe policia serbe vriste dhe masakronte shqiptarët anekënd Kosovës, prandaj për ta mbrojtë dhe çliruar popullin e Kosovës, në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), e cila u paraqit për herë të parë më 28 nëntor 1997. Platforma e saj për liri e pavarësi, për shoqëri të hapur e demokraci, u përkrah nga mbarë populli shqiptar. Lufta e UÇK-së u intensifikua sidomos pas luftës heroike të familjes Jashari në Prekaz, të udhëhequr nga Adem Jashari. Pushteti okupues serb futi në veprim një makineri të fuqishme ushtarakopolicore e propagandistike, jo vetëm kundër UÇK-së, por edhe kundër popullatës civile, rrjedhojë e të cilave janë skenat e llahtarshme të barbarisë së eskadronëve gjakatarë, vrasjet e masakrimet e njerëzve të pafuqishëm e të pafajshëm, djegiet e shtëpive, burgosjet masive, etj. Nga janari deri në dhjetor të vitit 1998 u vranë mbi 2 mijë shqiptarë, duke mos llogaritur këtu edhe një numër të madh të të zhdukurve, ndërsa numri i të zhvendosurve ishte 430 mijë, pjesa dërmuese e të cilëve përbrenda Kosovës. Nga Kosova, Ushtria Jugosllave dëboi me dhunë mbi 1 milion shqiptarë. Vetëm gjatë bombardimeve të NATO-s, ushtria serbe vrau rreth 15 mijë shqiptarë. Mbi 3 mijë shqiptarë

¹⁷ Shkëlzen Gashi , Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, Prishtinë, 2016, f.104

humbën pa gjurmë, ndërsa 5 mijë mbetën peng të Sërbisë. Mbi 1.500 ushtarë të UÇK-së ranë dëshmorë për lirinë e Kosovës.¹⁸

Politika paqësore dhe lufta e UÇK-së dhanë rezultatet e veta. Lufta e UÇK-së hyri në një fazë të re pas masakrës së Reçakut dhe dështimit të bisedimeve në Rambuje. Për t'ia ndalur hovin krimeve të Sërbisë ndaj shqiptarëve, ndodhi ndërhyrja ushtarake e bashkësisë ndërkombëtare. Pas tre muaj bombardimesh të NATO-s dhe aksioneve të vazhdueshme të UÇK-së, Ushtria Jugosllave u detyrua të tërhiqej nga Kosova. Në Kosovë, pos njësiteve të UÇK-së, hynë edhe forcat e NATO-s. OKB vendosi pushtetin civil, kurse NATO atë ushtarak. UÇK u shndërrua në TMK.¹⁹

¹⁸ Shkëlzen Gashi , Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë “Alter Habitus”, Prishtinë, 2016, f.105

¹⁹ Po aty

Ndërhyrja ndërkombëtare dhe Marrëveshja e Ramboje-së

Në shkurt 1998, Shtetet e Bashkuara të Amerikës morën nismën për të zgjidhur situatën me mjete diplomatike, siç dëshmon dhe dërgimi i Robert Gelbart, i dërguar i posaçëm për implementimin e Marrëveshjes Dayton, për të biseduar me Milosheviçin. Duket se Milosheviçit iu ofruan dy mundësi: të tregohej konstruktiv në gjetjen e zgjidhjeve të duhura për problemin e Kosovës ose të ndëshkohej më anë të sanksioneve të tjera dhe izolimit. Nga ana tjetër, duke përkufizuar UÇK-në si një grup terrorist,⁵⁸ dhe duke vlerësuar publikisht Milosheviçin, pa dyshim Gelbart u dha në dukje legjitimitet politikave të tij. Deklaratat e Gelbart ishin në përputhje me justifikimet e regjimit të Beogradit, i cili fajësonte për gjithçka që kishte ndodhur veprimtarinë iredentiste apo terroriste të UÇK-së. Janari i vitit 1999 solli përpjekje diplomatike të kombinuara me kërcënimin e përdorimit të forcës. Më 22 janar 1999, Grupi i Kontaktit miratoi një plan për të imponuar një zgjidhje politike, duke përfshirë përdorimin e forcës në qoftë se njëra nga të dyja palët, serbët ose shqiptarët, refuzonin të pranonin marrëveshjen. NATO u zotua për të mbështetur vendimet e Grupit të Kontaktit.²⁰

Më 6 shkurt 1999, filluan negociatat midis udhëheqjes serbe dhe udhëheqjes shqiptare, duke përfshirë edhe UÇK-në, e cila më përpara ishte cilësuar si një organizatë terroriste. Ky ndryshim i qëndrimit të diplomacisë ndërkombëtare ndaj UÇK-së ishte i bazuar në dy faktorë. Së pari, brutaliteti dhe vijueshmëria e sulmeve serbe mbi shqiptarët dhe paaftësia e drejtuesve të Kosovës për t'iu kundërvënë kishin marginalizuar Ibrahim Rugovën, përkrahësi i rezistencës jo të dhunshme. Shumë nga mbështetësit e tij u bashkuan me UÇK-në. Në fund të vitit 1998, UÇK-ja ishte një lëvizje e mirëorganizuar, me një staf gjeneralësh ushtarakë dhe me një kryesi politike civile. Kryesia drejtohej nga Hashim Thaçi, komandanti i UÇK-s, i cili mori pjesë në bisedimet në Rambouillet. Me këto zhvillime UÇK-ja u bë brenda Kosovës forca më e rëndësishme e rezistencës ndaj agresionit serb me mbështetje të gjerë popullore dhe legjitimitet ndërmjet shqiptarëve. Së dyti, marrja e UÇK-së si palë në negociatat "rriste koston e dhunës së Milosheviçit në Kosovë duke i dhënë atij më shumë stimuj për të negociuar një zgjidhje të pranueshme për NATO-n". Në këto rrethana, UÇK-ja nuk mund të lihej jashtë nga marrëveshja politike e Rambouillet. Teksti i parë i bisedimeve në Rambouillet, i cili iu paraqit

²⁰ Enika Abazi. Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm. Studime Historike, Institute of History, Tirana, 2012, f.211

palës shqiptare dhe asaj serbe kishte pesë pika kryesore: ndalimin e menjëhershëm të dhunës; tërheqjen nga Kosova të ushtrisë, policisë dhe forcave paraushtarake serbe; vendosjen e një force ushtarake ndërkombëtare të kryesuar nga NATO; rikthimin e sigurt të refugjatëve dhe popullsisë së shpërngulur në shtëpitë e tyre; një zgjidhje politike për autonomi të zgjeruar të Kosovës. Të dyja palët e kundërshtuan marrëveshjen. Serbët kundërshtuan prezencën e trupave të huaj në territorin e tyre, sepse për Serbinë, Kosova konsiderohej si çështje e saj e brendshme. Shqiptarët kundërshtuan mundësinë e një autonomie të zgjeruar, një status të cilin Kosova e kishte me Kushtetutën e vitit 1974.²¹

Në arsyetimin e shqiptarëve të Kosovës, zhvillimi i situatës në terren e kishte përjashtuar këtë alternativë. Dhjetë vjet shtypje që kishin kulmuar në veprime të dhunshme kishin bindur praktikisht të gjithë shqiptarët e Kosovës, se nuk mund të qëndronin në të njëjtin shtet me serbët. Rrjedhimisht, alternativa e pavarësisë ishte zgjidhja e vetme e pëlqyer nga i gjithë spektri politik i shqiptarëve të Kosovës. Negociatat rifilluan në 15 mars 1999. Teksti i ri i negociatave ofronte një zgjerim të autonomisë, që supozonte vetëqeverisje demokratike për të gjitha çështjet e brendshme, të tilla si edukimi, shëndetësia dhe ekonomia. Kosova do të kishte Presidentin dhe Asamblenë e saj. Marrëveshja do të garantohej nga trupa dhe zyrtarë të huaj. Autonomia e zgjeruar do të ofrohej përkohësisht, për një periudhë tre vjeçare. Gjatë kësaj periudhe parashikohej të mbahej një konferencë ndërkombëtare për të vendosur për statusin përfundimtar të Kosovës. Megjithatë, në thelb të marrëveshjes ruhej integriteti territorial dhe sovraniteti i Serbisë. Pala shqiptare e nënshkroi marrëveshjen, ndërsa serbët e refuzuan atë. Bisedimet dështuan në gjetjen e një zgjidhjeje paqësore. Ndërkohë zhvillimet në terren tregonin një përkeqësim të situatës humanitare. Dhjetëra mijëra njerëz filluan të braktisin shtëpitë e tyre përballë një ofensive të gjerë nga ana e forcave të armatosura serbe. Kjo i hapi rrugë përgjigjes ushtarake të NATO-s. Në përfundim të ndërhyrjes ajrore, vendimet e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 më 10 qershor 1999, do të shënonin në dukje fillimin e një periudhe të re për çështjen e Kosovës.²²

²¹ Enika Abazi. Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt I parashikueshëm. Studime Historike, Institute of History, Tirana, 2012, f.212

²² Po aty

KFOR-i

Misioni paqeruajtës në Kosovë i përbërë nga kombësi të ndryshme të Aleancës Veri-Atlantike por edhe më gjerë nga shtetet partnere të kësaj aleance, dha një shembull të mirëkuptimit dhe bashkërendimit të punëve në shërbim të një qëllimi. Ushtarët e KFOR dhe komuniteti ndërkombëtar kanë pastruar mbi 16 mijë shtëpi, 1.165 shkolla dhe rreth 2000 kilometra rrugë nga municionet dhe mina të paplasura. Mbi 43 mijë qytetarë kanë marrë shërbim shëndetësor në qendrat mjekësore të KFOR.

Shumë kush mund t'i kujton si pengesë dallimet tona në të kaluarën historike, kulturën, traditën, gjuhën apo religjionin tonë të ndryshëm nga njëri-tjetri, por këto nuk duhet të jenë pengesë e bashkimit tonë në një organizëm të përbashkët. Sepse këtë shembull e ka dhënë NATO në Kosovë. NATO përmes misionit të saj KFOR ka ndihmuar dhe vazhdon të ndihmoj në ndërtimin e një paqe të qëndrueshme, në ndërtimin e institucioneve demokratike, krijimin e mirëbesimit ndëretnik dhe ofrimin e një të ardhme të përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Për nga konteksti zhvillimor i sipas një raporti të USAID-it⁴⁹, Kosova ka vazhduar me shtegun e saj të ndërtimit institucional, të trendëve ekonomik dhe pjesëmarrjes qytetare. Megjithatë përparimi nuk ka qenë i njëtrajtshëm dhe shumë kushte mbesin problematike. Fundi i "pavarësisë së mbikëqyrur" në vitin 2012 dhe mbyllja e Zyrës Ndërkombëtare Civile (ICO) paraqiti sukses, dhe gjer tani 98 shtete kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Institucionet qeveritare, në veçanti në nivel qendror, vazhdojnë të forcojnë operimin e tyre, përderisa decentralizimi i pushtetit nëpër komuna po përforcon qeverisjen lokale dhe zhvillimin demokratik. Kosova ka një kornizë mjaft mirë të zhvilluar të ligjeve dhe politikave, edhe pse zbatimi i tyre shpeshherë ngecë. Gjatë tri viteve të kaluara nisën reformat fillestare brenda gjyqësorit. Ka pasur përparim në administrimin e zgjedhjeve konkurruese dhe kjo punë është kryer kryesisht në pajtim me standardet ndërkombëtare, edhe pse mbetet rreziku që parregullsitë në zgjedhje të nxisin konfliktin. Megjithatë në nivel ndërkombëtar, dhe përkundrejt përparimit të arritur, Kosova ende ka mungesë të njohjes zyrtare nga shumë shtete. Kjo ka penguar anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në organizatat tjera botërore dhe ka bërë që Bashkimi Evropian të miratojë një politikë "neutrale ndaj statusit" në lidhje me Kosovën, gjë që pengon mundësitë e saj në promovimin e plotë të zhvillimit të vendit. Kjo gjendje drejtohet nga mos-vullneti i Serbisë që të pranojë pavarësinë e Kosovës dhe të ndërpresë përkrahjen e strukturave të saj ilegale qeverisëse në komunat me shumicë serbe. Raportet e fundit rreth procesit të negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë tregojnë mundësinë e normalizimit të marrëdhënieve, por përparimi po arrihet me vështirësi. Gjer tani, sistemi "paralel" i qeverisjes në viset me shumicë serbe mbetet faktor i destabilizimit. Përkundër reformave institucionale, ende vazhdojnë të metat në zbatim, edhe pse në përgjithësi ekziston korniza adekuate e ligjeve dhe rregulloreve. Pavarësia e gjyqësorit dhe sundimi i ligjit mbesin të dobëta, përderisa mos-efikasiteti i vazhdueshëm brenda sistemit bën që dega e gjyqësorit të mos e luajë rolin e vet në mënyrë efektive si kundërpeshë ndaj degës së ekzekutivit. Deputetët e legjislativit (Kuvendi i Kosovës apo Kuvendi Kombëtar)

⁴⁹ Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018, https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_Kosovo_2014_ALB.pdf

gëzojnë autonomi të kufizuar, dhe pejsazhi politik mbetet i dominuar nga dega e ekzekutivit dhe nga liderët e partive politike. Kuvendi i Kosovës ka kapacitet joadekuat për të bërë analiza, për të hartuar legjislacion dhe për të siguruar mbikëqyrje (të zbatimit të ligjeve). Përparimi në bartjen e autorizimeve dhe përgjegjësi nga niveli qendror pengohet nga administratat komunale të cilat kanë aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimeve efikase publike, por edhe nga shërbyesit civil të cilët ndjekin interesat politike në barrë të elektoratit. Sistemi arsimor në Kosovë nuk adreson nevojat pedagogjike dhe nevojat për aftësimin e popullsisë më të re në Evropë, e kjo dobësi në sistem paraqet një pengesë gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të shtetit. Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim për shembull nga Maqedonia me 37% dhe Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektor shumë të vogël të eksportit, dhe me mungesë të energjisë. Bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori llogariten në 3,520 \$, dhe kështu Kosova radhitet në vendin e 93-të në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Ekonomia ka vazhduar me normën e rritjes prej 3-5% për afro një dekadë gjer në vitin 2011. Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS) përllogaritë se gjatë këtij trevjeçari (2013-2015) ekonomia do të rritet në mesatare për 4,7%, që është norma më e lartë mesatare në mesin e ekonomive të Evropës Juglindore. Megjithatë ritmi i rritjes fare nuk mjafton për të pasur efekte të dukshme në varfëri dhe papunësi. Për shembull, Banka Botërore përllogaritë se Kosova do të duhej që së paku të dyfishojë normën e rritjes dhe të arrijë së paku 12% rritje në vit për një dekadë të tërë për të arritur nivelin e tashëm të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) të Malit të Zi për kokë banori. Thënë shkurt, hendeuku në të ardhura në mes të Kosovës dhe shteteve tjera të Evropës Juglindore ka gjasë që të mbetet i thellë, përkundrejt rritjes më të madhe. Kosova është duke bërë përparim të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm makro-ekonomik si në ristrukturimin e fazës së parë (liberalizimi i çmimit, reformat në tregti dhe në shkëmbime të huaja si dhe privatizim) ashtu edhe në atë të fazës së dytë (politikat konkurruese dhe reformat në ndërmarrje, sistem bankar, infrastrukturë dhe reforma financiare jashtë bankare). Vendi ka performancë mjaft stabile ekonomike, edhe pse deficitit buxhetor në vitin 2011 është rritur në 4% të BPV-së. Vjelja e tatimeve është përmirësuar për 4% gjatë vitit 2012, në krahasim me periudhën e njëjtë një vit më parë. Megjithatë në vitin 2012 shpenzimet e Qeverisë së Kosovës tejkaluan të hyrat, gjë që rezultojë në deficit prej mbi 2%, dhe Ministria e Financave (MF) llogaritë se shpenzimet do të vazhdojnë të kalojnë të hyrat gjatë tri viteve të ardhshme. Kjo rritje

e shpejtë në shpenzimet publike tani për tani është forca kryesore ngasëse prapa rritjes së investimeve. Investimi privat ka mbetur në 20-22% të BPV-së për pesë vitet e fundit, përderisa investimet publike janë rritur nga 5% në 12% të BPV-së. Aktiviteti ekonomik është koncentruar kryesisht në sektorin e shërbimeve i cili është zgjeruar si rezultat i nivelit të lartë të remitancave dhe nga prezenca e madhe ndërkombëtare në Kosovë. Ende nuk ka pasur investim substancial produktiv në sektorin e mallrave tregtare. Deficiti i madh aktual (19% i BPV-së në vitin 2011) financohet kryesisht nëpërmjet ndihmave dhe remitancave. Në të vërtetë, Kosova është një nga dhjetë vendet me nivelin më të lartë të remitancave ku 13% e BPV-së vjen nga dërgesat e parave nga jashtë. Të dyja këto burime të të hyrave janë mjaft të brishta dhe varen nga kriza ekonomike në Evropë. Edhe pse remitancat ruajtën nivelin e lartë dhe mbetën stabile gjër tani, vetëm rreth 11% e parave shfrytëzohen për investime, kurse shumica e parave shkojnë për konsum. Përderisa Kosova ka bilanc shumë negativ të tregtisë ndërkombëtare (afro 45% e BPV-së në vitin 2011), është projektuar që eksportet të rriten shumë më shpejtë sesa importet, dhe si rezultat ky çekuilibër të përmirësohet bile paksa. Inflacioni mbetet i ulët, si rezultat i shfrytëzimit të Euros që ka pasur lëkundje të kufizuara monetare dhe kjo i ka kontribuar politikave relativisht të shëndosha fiskale. Kriza e fundit globale financiare ka pasur ndikim të kufizuar në ekonominë Kosovare si rezultat i nivelit të ulët të integritit të ekonomisë lokale me tregjet ndërkombëtare. Edhe pse shoqëria civile vetëm sa ka filluar të luajë rol proaktiv në avokim dhe mbikëqyrje, Kosova ka gamë të gjerë të organizatave të shoqërisë civile (OShC) dhe të medieve aktive. Kur qytetarët përfshihen në ndonjë çështje, kjo kryesisht bëhet nëpërmjet partive politike dhe iniciativave qytetare dhe të komunitetit. Problemet kryesore për qytetarët dhe për grupet e tyre të avokimit janë mungesa e mundësive ekonomike, frustrimi me institucionet qeveritare të cilat vazhdojnë të mos adresojnë nevojat më imediate që kanë të bëjnë me arsimin, mundësitë për punësim, shërbimet publike dhe qasjen e barabartë për gratë, të rinjtë dhe pakicat. Sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve, vetëm 17% e qytetarëve kosovarë pajtohen se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike, dhe si reagim, vullneti i qytetarëve për të votuar është në rënie. Integrimi i papërfunduar i pakicave, në veçanti i serbëve, kufizon mundësinë për ndërtimin e qeverisë më gjithëpërfshirëse.⁵⁰

⁵⁰ Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018
https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_Kosovo_2014_ALB.pdf

USAID-i që nga viti 1999 ka zbatuar një portofolin të gjerë të projekteve të cilat fokusohen në formimin e institucioneve demokratike, zhvillimin e institucioneve ekonomike dhe të sektorit privat, përmirësimin e aftësisë së qeverisë në menaxhimin e sektorit energjetik, në rindërtimin e sistemit arsimor dhe të infrastrukturës së komunitetit Asistenca kryesore teknike është ofruar për të ndihmuar hartimin e kushtetutës, në themelimin e gjykatës kushtetuese dhe në vendosjen e sistemit elektoral. Gjithashtu me ndihmën e USAID-it është krijuar edhe metodologjia për reduktimin e lëndëve vjetra gjyqësore. USAID-i i ka ndihmuar Kosovës në rigjallërimin e shoqërisë civile nëpërmjet ndihmës për qendrën burimore dhe për trajnime për organizatat joqeveritare (OJQ). USAID-i ka ndihmuar në themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV) që është institucioni i parë lokal i Qeverisë së Kosovës në pjesën veriore të vendit. Është dhënë asistencë edhe për themelimin e dy rrjeteve të para të pavarura televizive në Kosovë. Me ndihmën e USAID-it dhe duke filluar nga baza e ulët, përparime të mëdha janë arritur në vendosjen e politikave të reja ekonomike dhe fiskale, për të përgatitur skenën për tranzicion nga ekonomia e komanduar në atë të tregut. Sistemet buxhetore dhe tatimore si dhe sistemi gjithëpërfshirës pensional u krijuan dhe u funksionalizuan. U krijua sistemi modern bankar, u themelua Banka Qendrore dhe u vendosën kapacitetet për mbikëqyrje bankare. USAID-i themeloi një bankë komerciale, Bankën Amerikane të Kosovës, për të ndihmuar investimet, për të shtuar qasjen në financa dhe për të krijuar punësim (u dhanë kreditë me vlerë 64.5 milionë \$ për zhvillim të biznesit, gjë që rezultoi në 11.000 vende të reja pune). Një vit e gjysmë më vonë USAID-i ia shiti ndërmarrjen e suksesshme Bankës Raiffeisen të Austrisë, dhe të ardhurat nga shitja iu derdhën fondit të bursave (Fondi Kosovaro-Amerikan i Arsimit KAEF) që i mundëson banorëve të Kosovës të kryejnë studimet post-diplomike në Shtetet e Bashkuara. U përforcua kapaciteti kryesor i Ministrisë së Financave. U instaluan proceset moderne të buxhetit dhe të thesarit, me sistem efikas e transparent për menaxhim elektronik financiar që mundëson kreditim direkt të të gjitha pagesave qeveritare. U themelua administrata tatimore (1.2 milionë \$ tatime të vjela që nga janari i vitit 2012). U vendos korniza ligjore bërthamë për ekonomi funksionale të tregut. Së bashku, këto institucione të reja ekonomike, këto korniza rregullative dhe sisteme financiare, i kontribuan rimëkëmbjes pas konfliktit dhe ofrojnë perspektivë për revitalizim të vazhdueshëm ekonomik. U realizuan përmirësimet fillestare të institucioneve që punojnë me energji. Dhe çka është më e rëndësishmja, privatizimi i cilit pritet të bëhet së shpejti i sistemit të distribucionit të energjisë

është mundësuar nëpërmjet asistencës intensive të USAID-it. Që nga viti 2010, USAID-i në partneritet me Qeverinë e Kosovës ka reformuar sistemin arsimor të klasave 1-9 që përmirëson aftësitë e nxënësve dhe shton mundësinë e punësimit, një intervenim që në përgjithësi kuptohet si përmirësim i tregut të punës. USAID-i gjithashtu ka ndërtuar apo rehabilituar një numër të madh të infrastrukturës së komunitetit, siç janë shkollat (dhe kështu ka reduktuar punën në ndërrime), spitale dhe klinika shëndetësore, sisteme ujësjellësi dhe rrugë. Mbi pesëdhjetë studentë kanë magjistruar në institucionet e ShBA-së, dhe 12 studentëve pakicë i është dhënë bursa për studime bachelor. Grupet e cënueshme siç janë familjet e zhvendosura, gratë dhe fëmijët janë shënjestruar për kujdes të veçantë. Nga Stabilizimi në Shtetësi Gjatë pesë viteve të ardhshme USAID-i do të vazhdojë me këto suksese në përputhje me politikat e jashtme të qeverisë së ShBA-së dhe me konsideratat e sigurisë kombëtare, gjë që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe aktiv të qeverisë së ShBA-së në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe të pavarësisë së Kosovës, si mënyrë për të promovuar paqe më të madhe dhe stabilitet në Ballkan dhe për të ndihmuar integrimin rajonal dhe Euro-Atlantik. Duke punuar me përparësinë e ndjenjës së theksuar proamerikane që mbretëron brenda Qeverisë së Kosovës dhe në mesin e popullsisë, është detyrë e USAID-it që me sukses të përballët me sfidat dhe të shfrytëzojë mundësitë me të cilat përballët, ashtu që "Kosova të bëhet shtet gjithnjë e më i begatshëm, i cili në mënyrë progresive integrohet në komunitetin Euro-Atlantik, me qeverisje më efektive dhe më llogaridhënëse".

Sfidat madhore gjatë kohës së SBZhV-së kanë të bëjnë me arritjen e stabilitetit politik, përfshirë zgjidhjen e problemeve në pjesën veriore me shumicë serbe, nxitjen e pajtimit ndëretnik dhe integrimin e tërë popullsisë pakicë, dhe realizimin e përmirësimeve në sektorin e ekonomisë dhe të arsimit që do të shtonte mundësitë për të gjithë qytetarët dhe do të promovonte integrimin rajonal dhe Euro-Atlantik. Gjatë një dekadë e gjysmë, Kosova ka shënuar progres të dukshëm në fushat kritike të ndërtimit të institucioneve dhe në përforcimin e qeverisjes demokratike, krijimin e themeleve të shëndosha për rritjen e ekonomisë dhe në institucionalizimin e sistemit të decentralizuar e modern të arsimit fillor me mësimnxënie të bazuar në vlerësim dhe me fokusim te nxënësit. Megjithatë në të gjitha këto arena mbesin dobësi të rëndësishme të cilat duhet të adresohen me urgjencë nëse populli i Kosovës dëshiron të shfrytëzojë potencialin e vet të plotë si individ dhe si shtet. Gjatë kësaj periudhe të strategjisë, USAID-i synon të vazhdojë punën në këto angazhime në të gjitha këto fusha, duke punuar me Qeverinë e Kosovës dhe me aktorët tjerë me qëllim të tejkalimit të sfidave, nëpërmjet

shënjestrimin të vëmendshëm të asistencës në vijë me interesat e menaxhueshme dhe me realitetet buxhetore. Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja USAID-i përballlet me disa sfida me Qeverinë e Kosovës dhe me aktorët tjerë në lidhje me nevojën për të përforcuar institucionet kryesore dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve (OZh1: Të përmirësohet sundimi i ligjit dhe qeverisja ashtu që t'i përmbushin nevojat e qytetarëve). Së pari, vazhdimi i asistencës për sektorin e gjyqësisë kërkon që Qeveria e Kosovës të vazhdojë me zotimin e fuqishëm për të udhëhequr dhe zbatuar reformat kyçe, në veçanti në rindërtimin e gjykatave. Siç u tha më sipër, Kosova ka në përgjithësi një kornizë adekuate të ligjeve, por performanca gjyqësore duhet të përmirësohet dukshëm sa i përket efikasitetit, transparencës, pavarësisë dhe llogaridhënies. Në anketën e fundit, vetëm 18% shfaqën kënaqësinë me punën e gjykatave, dhe vetëm 16% ishin të kënaqur me punën e prokurorive. Anketa e njëjtë tregoi se vetëm 21% e qytetarëve ishin të kënaqur me punën e përgjithshme të Qeverisë⁷. Sa i përket institucioneve legjislative, Kuvendi i Kosovës mbetet i dobët, dhe siç tregon anketa e sipërpërmendur, është shumë e distancuar nga niveli më i ulët i elektoratit. Pa kulturë institucionale që thekson kontaktimin dhe punën me qytetarët, përmirësimet në funksionet legjislative, siç janë hulumtimi dhe analiza, hartimi i legjislacionit, dhe mbikëqyrja e zbatimit, do të kenë ndikim të kufizuar. Kjo vlen edhe për kuvendet komunale. Pushtetet lokale shpeshherë nuk mbajnë përgjegjësi para elektoratit të tyre dhe nuk demonstrojnë menaxhim të shëndoshë financiar. Shumë pushtete lokale vazhdojnë të kenë probleme në ofrimin efektiv të shërbimeve themelore, për shembull menaxhimi i drejtë i ujësjellësit dhe i kanalizimit, mbledhja e mbeturinave dhe lëshimi i dokumentacionit personal, siç janë certifikatat e lindjes. Disa komuna vënë në pah disa veprime të Qeverisë së Kosovës të cilat duken si lëvizje drejt centralizimit të sërishëm, edhe pse qeveria qendrore thotë se përkrah me fjalë decentralizimin e pushtetit të zyrtarët lokal të cilët janë më afër qytetarëve dhe realiteteve me të cilat ata përballen. Prandaj mbetet sfida vazhdimi i decentralizimit efektiv. Vlerësimi i fundit i USAID-it identifikoi zgjedhjet si nxitje e mundshme e konfliktit⁸. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) megjithatë pritet të ndryshojë përkrahjen e saj për zgjedhjet ashtu që në vend të këshillave dhe ndihmës, përkrahja e saj do të jetë vetëm në vëzhgim pa monitoruar zgjedhjet në terren. Duke i pasur parasysh këto ndryshime, do të jetë e vështirë të thuhet nëse Kosova do të ketë kapacitete për të menaxhuar me zgjedhjet në mënyrë kredibile. Qeveria e Kosovës ruan zotimin për të adresuar çështjet e pakicave, përderisa këtu sfida është rezistimi i presioneve të brendshme dhe i dinamikave shoqërore të cilat theksojnë karakterin etnik shqiptar të shtetit në

barrë të pakicave. Njëkohësisht Qeveria e Serbisë vazhdimisht i bën thirrje serbëve të Kosovës që të punojnë në sistemet paralele, ashtu që Qeveria e Serbisë financon administratat nën hije në viset me shumicë serbe në Kosovë. Natyrisht se kjo është në kundërshtim me integritetin dhe integrimin e Kosovës. Në fund, në të gjitha këto fusha, d.m.th. në fushën e gjyqësorit, legjislativit, administratës, zgjedhjeve dhe pakicave, dëshira dhe mundësia e shoqërisë civile që të punojë ngushtë me qeverinë dhe t'i jep zë konstruktiv brengave të tyre, gjithashtu do të dëshmohet si sfidë madhore, duke ditur nivelin e ulët të pjesëmarrjes aktive.⁵¹

Që të jetë më e qartë përfshirja e drejtpërdrejtë e institucioneve ndërkombëtare në zhvillimin e shtetit të Kosovës, më poshtë do të prezantojmë disa tabela që paraqesin qëllimin dhe objektivat konkrete zhvillimore të ndërmarra në periudhën paraprake.




Figura 1. Qëllimi i strategjisë për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendlit 2014-2018

⁵¹ Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendlit 2014-2018, https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_Kosovo_2014_ALB.pdf




Figura 2. Përmirësimi i sundimit të ligjit - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018

Kjo adreson drejtpërdrejtë një aspekt madhor të qëllimit strategjik, d.m.th. qeverisjen efektive dhe llogaridhënëse. Përderisa Kosova ka bërë progres në krijimin e politikave dhe ligjeve që do të çojnë kah arritja e këtij objektivi, në sektor mbetet një dobësi madhore që duhet të adresohet, jo vetëm për të arritur këtë objektiv, por si kërkesë themelore e domosdoshme për rritjen e përgjithshme ekonomike.




Figura 3. Rritja e investimeve dhe i punësimit në sektorin privat - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018

Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat. I përkrahur nga progresi në kuptim të përforcimit të institucioneve (OZh1) dhe nga popullsia më e aftësuar dhe e arsimuar (OZh3), ky objektivi zhvillimor do të promovojë rritjen e duhur të ekonomisë, që është me rëndësi qendrore për arritjen e qëllimit strategjik. Kosova tani radhitet si shteti më i varfër në rajonin e Ballkanit, dhe pa rritje ekonomike dramatike, synimi për standard të jetesës të krahasueshëm me Evropën do të mbetet iluzion, përderisa stabiliteti do të rrezikohej.




Figura 4. Forcimi i kapitalit njerëzor - Strategjia për Bashkëpunim e USAID-it në Kosovë për Zhvillimin e Vendit 2014-2018

Të Forcohet Kapitali Njerëzor. Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejtë në krijimin e një Kosove më të begatshme dhe arritjes së OZh1, OZh2 dhe të qëllimit strategjik, duke siguruar se shteti ka popullsi më të arsimuar që siguron funksionimin efikas të institucioneve kryesore, se janë plotësuar nevojat e ekonomisë së ndryshme për kualifikime, se zëri i qytetarëve do të dëgjohet kur ata kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga organet publike, dhe se individët mund t'i realizojnë më mirë dëshirat e tyre për karrierë të begatshme dhe jetë më të lumtur personale dhe më të sigurt në aspektin ekonomik.

KAPITULLI – VI

Roli i shoqërisë civile në demokratizimin e shoqërisë dhe kualitetin e shërbimeve publike

Si organizatat qeveritare ashtu edhe ato joqeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e formulimit të politikave publike. Aktorët institucional gjatë aktiviteteve të tyre zyrtare participojnë në vendimmarrje në nivele të ndryshme dhe kanë për qëllim që të merren me çështje të tilla si politika e jashtme dhe e brendshme, shëndetësi, arsim, punësim, ekonomi, drejtësi, mjedis, energji, transport, strehim, bujqësi, gjyqësi dhe një mori çështjesh tjera. Varësisht nga pozicioni dhe roli që kanë aktorët institucional dhe joinstitucional në organizatat përkatëse, varet edhe pjesëmarrja e tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave në një fushë të caktuar. Në të gjitha këto raste ndryshon roli dhe fushëveprimi i organizatave publike, private ose jo-fitimprurëse, sepse zhvillojnë dhe menaxhojnë me veprimtari të ndryshme, por në të njëjtën kohe, të gjitha ato në mënyrë të veçantë tentojnë të ndikojnë në politikbërjen dhe të mbrojnë interesin e anëtarësisë së vete.⁵²

Shoqëria civile ka një histori të gjatë veprimi, e cila ka kaluar në disa faza të rëndësishme. Ajo, në fakt, është përballur me shumë vështirësi dhe natyrisht gjatë periudhave historike ka pasur edhe ndryshime, si në strukturën organizative, po ashtu edhe në veprimtarinë e saj. Megjithatë, qëllimi fundamental i shoqërisë civile ka qenë që të ngreh zërin e saj karshi padrejtësive që janë bërë sidomos nga shteti. Gjatë periudhave historike, shoqëria civile ka pasur një rol me rëndësi, që sidomos ishte një goditje e fortë për komunizmin, çka më së miri lidhet me mendimin e babait të “racios” Makiavellit, i cili dikur theksonte se “shteti lindor do të shkatërrohej me një të fryrë të vetme, vetëm po të goditej në qendër”, e këtë më së miri e pasqyroi shoqëria civile e cila e goditi po aty. Prandaj, rrjedhimisht, shoqëria civile konsiderohet si njëra prej shtyllave të vet demokracisë, madje dallimi prej sistemit monist-komunist dhe demokracisë qëndron edhe tek shoqëria civile. Edhe pse në parim, shoqëria civile mund të themi se ka prejardhje prej Adam Fergusonit, megjithatë, kur përmendet fjala shoqëri civile, ajo nënkupton çdo lloj organizimi që është joshtetëror, por gjithashtu zgjon konotacionin e shoqërisë ku sundon presioni i opinionit publik dhe rendi ligjor. Po ashtu, ka argumente të ndryshme dhe të

⁵² J. Abdullaj, “Politika dhe politikat publike”. Arbëria Design, 2016, Tetovë, f. 175

shumta se shoqëria civile i ka rrënjët tek doktrina Hegeliane, por edhe më herët sidomos tek Greqia antike. Ernest Gellner, shoqërinë civile e përkufizon si një grumbull i institucioneve të ndryshme joqeveritare, i cili është mjaft i fuqishëm që ta balancojë shtetin. Shoqëria civile, pra thjesht konsiderohet aktiviteti shoqëror i njerëzve jashtë familjes, shoqërisë, dhe vendeve të tyre të punës, dhe që nuk ka qëllime fitimprurëse apo synime për të marrë pushtetin. Ajo pra nënkupton vullnetin e përbashkët të njerëzve që t'i ndjekin interesat apo dëshirat e tyre. Roli i tyre është shkëmbimi i informacionit, arritja e qëllimeve kolektive, formulimi i kërkesave të tyre drejtuar shtetit, përmirësimi dhe funksionimi i shtetit si dhe mbajtja e zyrtarëve përgjegjës ndaj obligimeve të tyre shtetërore. Shoqëria civile, pra, qëndron mes sferës private dhe shtetit.⁵³

Historia e shoqërisë civile në Kosovë është pjesë e një historie më të gjerë të Evropës Lindore gjatë rënies së komunizmit, por gjithashtu ka qenë e formësuar nga rrethanat e veçanta të Kosovës dhe nga shkatërrimi i Jugosllavisë. Kur Kosovës iu hoq autonomia në vitin 1989, shoqëria civile u bë pjesë e rezistencës dhe bashkëpunonte nga afër me qeverinë paralele, që u formua si akt i kundërshtimit të Beogradit dhe që ofronte shërbime alternative në fushën e shëndetësisë, të mirëqenies sociale dhe të arsimit. Pra, shoqëria civile e Kosovës ka lindur në erën e represionit dhe të kundërshtive. Organizatat e para të shoqërisë civile në Kosovë datojnë nga fundi i viteve '80 dhe fillimi i viteve '90, pra konkretisht pas rënies së komunizmit. Në rastin e Kosovës gjatë viteve 90, për shkak të shtypjes politike në atë kohë, shoqëria civile është zhvilluar si pjesë e rëndësishme e një sistemi paralel dhe i rezistencës civile ndaj regjimit serb, dhe kishte trajtuar kryesisht çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe mbijetesës së popullsisë. Pra, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe çështjet tjera humanitare, kanë qenë fushatë më të rëndësishme të aktiviteteve të shoqërisë civile në atë kohë. Në krahasim me kohën e tanishme, organizatat kryesore të shoqërisë civile në atë kohë ishin kryesisht organizata bamirëse dhe humanitare, si rasti i organizatës "Nëna Terezë" – e cila merrej kryesisht me ofrimin e ndihmës mjekësore dhe humanitare, me një anëtarësi shumë të madhe vullnetarësh, e shpërndarë në të gjithë Kosovën.⁵⁴

Shoqëria civile sot konsiderohet një ndër faktorët kryesor të forcimit demokratik të një vendi. Ata që preken nga një vendim politik, duhet të shprehin mendimin e tyre dhe ky është një

⁵³ Xhavit Drenori, Konsolidimi i demokracisë në Kosovë – sfidat, Universitetit European të Tiranës, Tiranë, 2018, f.159

⁵⁴ Po aty.

parim demokratik. Kosova dhe Shqipëria janë dy shtete të Ballkanit Perëndimor, që pretendojnë t'i mbrojnë vlerat demokratike, dhe roli i shoqërisë në këto dy shtete është i një rëndësie jetike. Ky hulumtim është një analizë krahasuese e gjendjes aktuale të shoqërisë civile në Kosovë dhe në Shqipëri. Analiza është bazuar mbi tri raporte; raporti vjetor i USAID mbi zhvillimin e shoqërive civile, raporti i Komisionit Evropian dhe raporti analitik i indeksit të shoqërisë civile-CIVICUS. Përmes këtyre raporteve do të vihet në pah roli aktual i shoqërisë civile në Kosovë dhe Shqipëri, duke marrë parasysh faktin sa kanë ndikim ato në proceset politike të vendeve të tyre, se sa janë ato zëshme e sa të “pavarura” dhe cilat janë vështirësitë më të mëdha që ato hasin në zbatimin e detyrave të tyre. Por, para se të vijmë deri tek analiza krahasuese, do duhej të definohej fillimisht koncepti “shoqëri civile” dhe rolin të cilin duhet ta ketë në demokraci. Ernest Gellner, shoqërinë civile e përkufizon si një grumbull i institucioneve të ndryshme joqeveritare i cili është mjaft i fuqishëm që ta balancojë shtetin. Shoqëria civile, pra thjesht konsiderohet aktiviteti shoqëror i njerëzve jashtë familjes, shoqërisë, dhe vendeve të tyre të punës, dhe që nuk ka qëllime profitabile apo synime për pushtet. Ajo thjesht nënkupton vullnetin e përbashkët të njerëzve që t'i ndjekin interesat apo dëshirat e tyre. Roli i tyre është shkëmbimi i informacionit, arritja e qëllimeve kolektive, formulimi i kërkesave të tyre drejtuar shtetit, përmirësimi dhe funksionimi i shtetit si dhe mbajtja e zyrtarëve përgjegjës ndaj obligimeve të tyre shtetërore. Shoqëria civile është një fenomen ndërmjetës, që qëndron mes sferës private dhe shtetit.

Duke u bazuar në raportet profesionale, shoqëritë civile në Kosovë pothuajse ballafaqohen me të njëjtat sfida. Për këtë arsye mund të vijmë dhe në ca përfundime të njëjta. Shoqëritë civile kosovare duket se janë larg detyrës së tyre si kundër balancues i shtetit. Një pjesë e konsiderueshme e fajit, u takon vetë autoriteteve shtetërore, të cilat në njërin anë po e anashkalojnë sektorin e shoqërisë civile, e në anën tjetër thirren si administratorë të demokracisë. Si rrjedhojë e kësaj ndikimi i tyre në proceset politike është i paefektshëm. Mirëpo, ndikimi i shoqërisë civile në proceset sociale dhe politike ka rezultuar të jetë më i ulët në Kosovë në raport me Shqipërinë. Megjithatë, pjesa më e fuqishme e organizatave të shoqërisë civile të të dyja shteteve mbetet kapaciteti i tyre organizativ, i cili sidomos në Kosovë është tejet solid. Po ashtu, mungesa e njohurive të qytetarëve për rolin të cilin e ka një shoqëri civile në demokraci, bënë që angazhimi qytetar të jetë në nivel të ulët. Prandaj, organizatat e shoqërisë civile nuk duhet vetëm të thirren në emër të qytetarëve, por duhet të jenë dhe më afër tyre, duke i përfaqësuar denjësisht interesat e tyre qytetare. Në fund të fundit, një shoqëri civile mund të forcohet vetëm nëse ka

mjaft individë guximtarë, të cilët e kuptojnë se çka është ajo të cilën e dëshirojnë dhe kanë shkathtësi dhe këmbëngulësi politike të përpiqen për ta realizuar atë.⁵⁵

Shoqëritë civile luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme të cilët ata i zhvillojnë në bazë të programeve të tyre vjetore. Sipas Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile, Deri në dhjetor 2017, Regjistri i OJQ-ve ka numëruar 9,545 OJQ, ku mbi 95% janë të regjistruara si shoqata dhe pjesa tjetër fondacione. Rreth 1/3 e OJQ-ve të regjistruara janë nga komuna e Prishtinës, pasuar nga Prizreni dhe Mitrovica më një përqindje dukshëm më të vogël. OShC-të kanë përbërje gjinore të balancuar, për dallim nga sektorët tjerë në Kosovë ku gratë nuk e arrijnë as 1/3 e numrit të të punësuarve. Të dhënat nga studimi sugjerojnë se numri i OShC-ve aktive në Kosovë është rreth 1,000. Megjithatë, të dhënat zyrtare për organizata të shoqërisë civile vazhdojnë të mos jenë sistematike, duke përfshirë këtu edhe numrin e organizatave aktive dhe fushën e angazhimit apo karakteristikat tjera. Korniza ligjore bazë për funksionimin e shoqërisë civile nuk ka pasur ndryshime. Edhe pse regjistrimi në autoritetet shtetërore nuk është parakusht për funksionim të një organizate të shoqërisë civile, shumica dërrmuese e tyre regjistrohen. Në përgjithësi, nuk janë vërejtur kufizime të lirisë së asocimit, lirisë së tubimit, apo lirisë së shprehjes të anëtarëve të shoqërisë civile. Derisa OShC-të tregojnë nivel të lartë të zbatimit të kërkesave financiare dhe tatimore, Kosova vazhdon të mos ketë sistem të përshtatshëm për raportim financiar të OShC-ve, rrjedhimisht, OShC-të raportojnë në mënyrë të njëjtë sikurse bizneset. Kërkesat ligjore për qeverisje të brendshme të OShC-ve janë minimale, por megjithatë, ato zbatohen pak. Edhe pse obligim ligjor, më shumë së gjysma e shoqatave nuk e deklarojnë Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë vendimmarrës. Ngjashëm me edicionin e kaluar të Indeksit, sërish konfirmohet se posedimi i dokumenteve për rregullim të brendshëm të OShC-ve është i ndërlidhur me madhësinë dhe kapacitetet e organizatës. Rrjedhimisht, shumica dërrmuese e OShC-ve të mëdha dhe të konsoliduara posedojnë dokumente për rregullim të brendshëm. Përkundër që një numër i madh i OShC-vë operojnë pa fonde, prapë se prapë, ky sektor punëson një numër të konsiderueshëm të stafit në radhët e veta. Të dhënat e këtij viti tregojnë një rritje të shumës totale të kontributeve të paguara nga të punësuarit në OShC, të cilët përbëjnë rreth 3.25% të kontribuesve në Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Në anën tjetër, shteti nuk

⁵⁵ Pajtim Zeqiri, 2013 Qendra për Arsim, Krahasoni i gjendjes së shoqërive civile në Kosovë dhe Shqipëri, KIPRED, Prishtinë, 2013

ka dhe as nuk ka treguar interesim për politika të cilat do t'i trajtonin nevojat e veçanta të këtij sektori. Angazhimi i qytetarëve në OShC mbetet i ulët, në përgjithësi. Megjithatë, krahasuar me vitet e kaluara vërehet një rritje e dukshme e numrit të qytetarëve që janë angazhuar në OShC, kanë bërë punë vullnetare për OShC, apo që kanë përfituar nga shërbimet që ofrohen nga OShC-të. Në anën tjetër, vërehet ka një rënie të lehtë të besimit të qytetarëve në shoqërinë civile dhe vlerësimit për punën që ky sektor bën. Megjithatë, shoqëria civile mbetet ndër sektorët më të besueshëm në Kosovë. Angazhimi vullnetar i qytetarëve në organizata të shoqërisë civile është rritur ndjeshëm krahasuar me dy vite më parë, gjë që konfirmon se shoqëria civile vazhdon të ketë më shumë vullnetarë se sa të punësuar.⁵⁶ Githnjë sipas këtij indeksi, gati gjysma e OShC-ve në Kosovë operojnë pa fonde fare, dhe një numër shumë i madh i tyre operojnë me më pak se 10,000 EUR në vit. Vërehet një trend në rënie i financimit të OShC-ve në të gjithë indikatorët që masin këtë aspekt, përveç fondeve publike. Donatorët e huaj vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit për OShC në Kosovë, edhe pse me një rënie të dukshme krahasuar me të dhënat e vitit 2015. Në anën tjetër, është rritur financimi i OShC-ve nga fondet publike, si dhe numri i organizatave që kanë përfituar fonde nga institucionet publike. Edhe pse ka një rritje të përkrahjes institucionale për OShC, dominon përkrahja për projekte me afat të shkurtë dhe shuma të vogla, derisa shumë pak OShC përfitojnë përkrahje jo-financiare. Demokratizimi vlerësohet si fusha ku shoqëria civile ka ndikim më së shumti, e pasuar nga sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, arsimit, dhe barazia gjinore. Njëjtë sikurse në edicionet paraprake të Indeksit, akterët jashtë shoqërisë civile kanë mendim shumë më pozitiv për ndikimin e shoqërisë civile në fushat e lartpërmendura. Përkundër që vërehet një përmirësim i qasjes në informata në institucione publike, në përgjithësi, OShC-të vlerësojnë se nuk janë mjaftueshëm të informuar nga institucionet publike për fushat në të cilat angazhohen. Në anën tjetër, edhe kur OShC-të kërkojnë qasje në dokumente publike, ato i marrin me vonesë. Krahasuar me vitin 2015, vërehet një rënie e madhe e numrit të organizatave që kanë marrë pjesë në ndonjë proces të politik-bërjes, apo që kanë pranuar ftesë për konsultim publik nga institucionet publike.

Ndikimi i shoqërisë civile në politikat publike ka potencial të jetë thelbësor. Ajo mund të kontribuojë në cilëndo prej pesë fazave të politikëbërjes: përcaktimin e agjendës, formulimin e politikave, vendimmarrjet, zbatimin dhe vlerësimin. Një nga instrumentet më të fuqishme për

⁵⁶ Dren Puka, Indeksi Kosovar I Shoqërisë Civile 2018, <https://www.kcsfoundation.org/wp-content/uploads/2018/12/Indeksi-Kosovar-i-Shoq%C3%ABris%C3%AB-Civile-2018.pdf>

futjen e ndonjë çështjeje në agjendën publike dhe ndikimi në debatet pasuese janë mediat. Grupet e ekspertëve dhe OShC-të e tjera po ashtu mund të kenë ndikim mbi qeverinë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes partive politike, me të cilat ato nganjëherë janë të ndërlidhura. Në Kosovë, rruga më e mirë për të pasur ndikim mbi qeverinë është nganjëherë përmes ndonjë organizate ndërkombëtare apo agjencie të OKB-së. Në fazën e zbatimit, OShC-të shpesh mund të luajnë një rol për zbatimin e shërbimeve të autorizuar nga qeveria. Në këtë rast, roli i tyre është kyç në vlerësimin e rezultateve të politikave. Sidoqoftë, përparimet që ka Kosova dhe roli i shoqërisë civile në vendin tonë, vërejmë se mbetet ende e dobët përballë rëndësisë së madhe që ka kjo shoqëri për plotësimin e hapësirave mes politikës, qeverisë dhe qytetarëve të saj. Kontributi i shoqërisë civile dhe i qytetarëve është dhe mbetet esencial dhe tejet i rëndësishëm për përshpejtimin e reformave të domosdoshme që shpesh bëhen atraktive për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e vetë shoqërisë dhe e qytetarëve të saj.⁵⁷

Në raport progresin e Komisionit Evropian për Kosovën vitin 2019⁵⁸, thuhet se shoqëria civile e Kosovës duhet të vazhdojë dhe të aftësohet më tej, për të luajtur një rol të rëndësishëm në debatin demokratik dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Më tej aty thuhet se Kuvendi më në fund miratoi në prill 2019 një Ligj të ri për Lirinë e pjesëmarrjes në organizatat joqeveritare, i cili përmirëson mbrojtjen ligjore të OJQ-ve, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ky ligj përmbysi ndryshimet kontestuese të miratuara nga Kuvendi në nëntor 2018.

Në tetor 2018, një vlerësim sektorial i rrezikut për pastrim parash dhe antiterrorizëm në sektorin e OJQ-ve u përmbyll nga Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës, në konsultim me një numër të organizatave të shoqërisë civile.

Me një vonesë, po përgatitet një strategji e re 2019-22 për bashkëpunim të strukturuar midis qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile. Prioritetet e reja strategjike synojnë të zgjerojnë pjesëmarrjen në OJQ me bazë komunitare dhe të sigurojnë qëndrueshmërinë e organizatave.

⁵⁷ Xhavit Drenori, Konsolidimi i demokracisë në Kosovë – sfidat, Universitetit Evropian të Tiranës, Tiranë, 2018, f.165

⁵⁸ Raport progresi për Kosovën, Komisioni Evropian, 2019
<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Konsultimet publike nga qeveria po përmirësohen, përfshirë edhe përmes një përdorimi të shtuar të konsultimeve publike në internet. Për herë të parë, një raport vjetor mbi konsultimet publike të qeverisë u prodhua në maj 2018. Sidoqoftë, disa organe publike kanë ende kapacitete të kufizuara për të zbatuar detyrimet e tyre për konsultime ligjore. Institucionet duhet të rritin përpjekjet e tyre për të siguruar një reagim më të qëndrueshëm dhe kuptimplotë për informacionin e marrë dhe për të zgjeruar mjetet e këshillimit të përdorura për të arritur një audiencë më të gjerë në mënyra efektive. Vazhdon puna për të prezantuar standardet e këshillimit publik edhe në nivelin komunal. Ende ekziston nevoja për një transparencë sistematike në shpërndarjen e fondeve publike për OJQ-të.

Ndërsa disa ministri dhe bashki, për herë të parë kanë kryer thirrje të hapura në përputhje me kërkesat ligjore, shumë ministri dhe komuna ende nuk kanë aftësi për të përmbushur kërkesat e reja. Publikimi i një raporti vjetor të qeverisë për fondet publike është një praktikë e mirë, por raporti duhet të jetë më i detajuar. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të adresuar rreziqet e konfliktit të interesave dhe forcimin e profesionalizmit dhe integritetit brenda komisioneve vlerësuese që vendosin për grante për OJQ-të. Kuadri ligjor për zbritjet tatimore për dhurime mbetet i paqartë.

Në Kosovë siç edhe cekëm më lart janë duke funksionuar shumë organizata jo-qeveritare të cilat merren me aspektin e zhvillimit të kapaciteteve institucionale të Kosovës. Në vijim do të cekim disa organizata të cilat janë më të shquara në këtë kontekst.

KIPRED

Misioni i KIPRED-it është promovimi dhe konsolidimi i demokracisë dhe i vlerave demokratike në Kosovë dhe në rajon përmes hulumtimeve të pavarura, zhvillimit të kapaciteteve, dhe ndërtimit të institucioneve.

Objektivat e kësaj organizate janë si në vijim:

- Të bëjë dhe të zhvillojë hulumtime të pavarura të politikave publike në fushën e qeverisjes demokratike, dhe të çështjeve rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe të sigurisë
- Të ndikojë në proceset e politikë-bërjes publike
- Të ndërtojë institucione përgjegjëse publike
- Të ofrojë mësim të nxjerra në ruajtjen e paqes, ndërtimin e paqes, ndërtimin e institucioneve, zhvillim dhe tranzicion pas konflikteve
- Të ofrojë burime për zhvillimin e hulumtimeve profesionale dhe analizave cilësore në politikat publike dhe shkencat shoqërore.

Puna e KIPRED-it mbështetet në vlera parimore siç janë: sundimi i parimeve demokratike; paanshmëria e plotë; bashkëpunimi me institucionet publike dhe grupet e qytetarëve për promovimin e demokracisë; dhe bashkëpunimi me institucione të natyrës së ngjashme, si vendore, rajonale ashtu edhe ndërkombëtare.⁵⁹

⁵⁹ <http://www.kipred.org/sq/per-ne>

LËVIZJA FOL

Lëvizja FOL filloi punën e saj në vitin 2008 si një projekt në kuadër të Programit për Qytetari Aktive në Forumin për Iniciativa Qytetare ndërsa më vonë në vitin 2009, është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare e pavarur me seli në Prishtinë, ku themelues të saj ishin Petrit Zogaj, Mexhide Demolli-Nimani dhe Ramadan Ilazi.⁶⁰

FOL angazhohet për promovimin e politikave dhe praktikave të qeverisjes së mirë, të bazuara në vlera të përbashkëta të transparencës dhe llogaridhënies, dhe punon për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, përmes hulumtimit dhe analizës së politikave publike, dhe mbështetjes dhe nxitjes së pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Vizioni imkësaj organizate është shoqëri me qeverisje demokratike ku pjesëmarrja aktive e qytetarit në proceset e politikë-bërjes dhe ato të vendimmarrjes publike është bazë e qeverisjes transparente, llogaridhënëse dhe në mbrojtje të interesit publik.

Vlerat e lëvizjes FOL janë si në vijim:

- Shoqëria e hapur, të menduarit kritik dhe diversiteti;
- Demokracia e bazuar në qytetari aktive;
- Qeverisja e drejtë e bazuar në promovimin dhe respektimin e të drejtave e lirive të njeriut;
- Shteti i së drejtës;
- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Guximi qytetar dhe besueshmëria;
- Drejtësia dhe dinjiteti;
- Integriteti dhe profesionalizmi;
- Bashkëpunimi dhe partneriteti;
- Puna ekipore dhe paanshmëria;
- Përgjegjshmëria, transparenca dhe llogaridhënia;
- Promovimi dhe mbrojtja e interesit publik.

⁶⁰ <http://levizjafol.org/per-ne/>

Parimet e lëvizjes FOL janë si në vijim:⁶¹

- Lëvizja FOL punon dhe angazhohet, në kuadër të qëllimeve që i ka caktuar vetës;
- Lëvizja FOL mban qëndrime ndaj çështjeve të ndryshme pas konsultimeve të gjëra;
- Qëndrimet tona publike do të reflektojnë rezultatet e hulumtimeve, analizave dhe argumenteve parimore;
- Lëvizja FOL bashkëpunon me të gjitha grupet qeveritare, jo-qeveritare, fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, individë, e të tjerë që mbështesin kauzën dhe qëllimet e saj;
- Lëvizja FOL është ndërtuese koalicionesh dhe rrjetesh të interesit të përbashkët për të ndihmuar proceset sociale, ekonomike dhe politike në vend;
- Lëvizja FOL është e përgjegjshme, e hapur dhe llogaridhënëse në marrëdhëniet e saj me anëtarësinë, mbështetësit, bashkëpunëtorët, donatorët dhe qytetarët.

Për më tepër, FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje.

FOL, nëpërmjet hulumtimeve, fushatave të edukimit, si dhe avokimit do të realizojë aktivitete që do të ndihmojnë qytetarët dhe qeverinë të afrohen më shumë me qëllimin përfundimtar për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.

FOL do të jetë një frymë që përfaqëson qytetarët, tanimë të një shteti të pavarur, që të luajnë rolin tyre të domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe të punojnë për avancimin e shtetit.

Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

⁶¹ <http://levizjafol.org/per-ne/>

LËVIZJA ÇOHU!

E themeluar në shtator të vitit 2005, Çohu! është kufizimi i ndikimit të korrupsionit politik në institucionet publike të Kosovës. Përderisa Kosova mbetet një vend i varfër dhe i pazhvilluar, me rritje të ulët ekonomike, korrupsioni duket të ketë marrë një kahje tjetër, atë të zgjerimit. Për ta zvogëluar korrupsionin dhe për ta hapur rrugën për zhvillim, Çohu angazhohet për institucione transparente dhe llogaridhënëse. Në kuadër të aktiviteteve të saj, Çohu i

- monitoron rastet e dyshuara të korrupsionit në gjykatat e Kosovës,
- monitoron dhe raporton mbi parashkrimin e lëndëve të korrupsionit,
- rishikon dhe propozon ndryshime të infrastrukturës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit.
- Bën rishikimin dhe analizimin e kontratave të prokurimit publik, aktivitet ky në të cilin organizata është specializuar dhe ka zhvilluar metodologji të veten hulumtuese duke gjeneruar kështu të dhëna të rëndësishme mbi shpenzimet publike.

Për të nxitur hulumtimin dhe për të arritur tek audienca më të gjera, Organizata Çohu ka themeluar krahun e saj gazetaresk, Qendrën Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH) e cila e publikon revistën “Preportr”. Përmes aplikimit të metodologjisë së zhvilluar, “Preportr” ka publikuar hulumtime jetike mbi:

- patronazhin politik,
- klientelizmin,
- prokurimin publik,
- energjinë,
- shëndetësinë,
- arsimin e lartë,
- kompanitë publike si PTK, KEK dhe ANP,
- apo mbi kontratat investuese të ashtuquajtura “strategjike” me vlerë të lartë monetare siç është “Rruga e kombit”.

Me rritjen e punës sonë, po rritemi edhe ne. Jemi gjithmonë në kërkim të vendeve të reja, të territoreve të reja për eksplorim dhe të fushave të reja për hulumtim. Lëvizja në drejtim të fushës së “të dhënave të hapura” (Open Data), që t’i eksplorojmë ato dhe t’i shndërrojmë në mjet për arritjen e një transparence dhe llogaridhënieje më të lartë të institucioneve publike, është, mes tjerash, një nga qëllimet e Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Demokratizim. Teknologjitë e reja ua mundësojnë organizatave të shoqërisë civile që të jenë më efikase dhe të arrijnë tek një publik më i gjerë. Duke qenë në mes të një organizate mbikëqyrëse (watchdog) dhe të një organizate hulumtuese (think-tank), Çohu nuk vendos kufij sa i përket përdorimit të metodave të ndryshme për të arritur synimet e saj të krijimit të institucioneve transparente, llogaridhënëse dhe demokratike. Në kuadër të kësaj organizate funksionojnë disa zyra edhe atë:

Zyra për Demokratizim dhe Integritet Publik ka si fushëveprimtari monitorimin e punës së qeverisë dhe projekteve me rendësi për vendin. Kjo zyre fillimisht është marrë me monitorimin e punës së Qeverisë në çdo 100 ditë punë duke analizuar proceset me rendësi në periudha të ndryshme kohore. Ky departament së fundmi është marrë me monitorimin e tenderëve në ministritë me buxhet më të madh me rast është krijuar databaza e Organizatës me të dhënat përkatëse. Nga kjo Organizata publikon raporte analitike rreth shpenzimit të parasë publike, duke analizuar bizneset dhe rajonet të favorizuara, si dhe ndikimin politik në vetë shpenzimin e parasë publike.

Nëpërmjet **Zyrës së Këshilltarit Ligjor dhe të Monitorimit të Legjislacionit Antikorrupsion** Organizata ÇOHU! është një pjesëmarrëse e përhershme në grupet punuese për përpilimin e ligjeve. Përveç pjesëmarrjes në grupet punuese me Kuvendin e Kosovës dhe institucionet tjera, jo rrallë ÇOHU! kërkon bashkëpunim me organizata tjera në ekspozimin e pikave të dobëta të identifikuara në legjislacionet ekzistuese dhe ato që janë në përgatitje e sipër.

Pjesë e rëndësishme e kësaj zyre është edhe kontakti me palët që kanë informacione dhe dokumente për të denoncuar, të cilat Zyra e këshilltarit ligjor i analizon dhe i raporton në Zyrën e Prokurorit Special, apo edhe në zyra tjera në varësi të rastit..

Zyra për Kompanitë Publike dhe Privatizim. Promovimi i praktikave të mira në menaxhim të aseteve publike, por edhe identifikimi i i korrupsionit, konfliktit të interesit dhe të keqmenaxhimit, është një pjesë e veçantë e punës së Organizatës. Ekspertët e organizatës në këtë

fushë, por edhe bashkëpunimi me ekspertë nga jashtë, kanë bërë shpesh që ÇOHU! të jetë bartëse e debatit rreth politikave të qeverisë sidomos në raport me kompanitë publike. ÇOHU! ka qenë akteri kryesor në monitorimin e politikave mbi kompanitë publike dhe për këtë ka informuar dhe sensibilizuar në vazhdimësi Kuvendin e Kosovës. Rezultat i një punë të kësaj zyreje për herë të parë Kuvendi i Kosovës refuzoi tre herë radhazi Strategjinë e qeverisë për privatizimin e PTK-së me kërkesë për sqarime të mëtutjeshme, gjë që ka kontribuar në shtimin e kontrollit ndaj ekzekutivit në krijimin e politikave ekonomike.

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese. Duke parë mungesën e investimit të mediave kosovare në gazetarinë hulumtuese dhe të pavarur, ÇOHU! ka themeluar një qendër për raportim hulumtues dhe për përkrahjen e gazetarëve hulumtues. Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese (Kosovo Centre for Investigative Journalism – KCIJ) bashkëpunon në baza të rregullta me dhjetëra gazetarë, kurse punon aktivisht me rreth dhjetë prej tyre në hulumtimin e temave sidomos në fushën ekonomike dhe tema që kanë lidhshmëri me menaxhimin e kompanive publike. QKGH boton një shtojcë të përdymuajshme në dy gazetat më të mëdha ditore, gjegjësisht në “Koha ditore” dhe në “Zëri”. Poashtu, kjo qendër boton një lloj shumë specifik të një magazine online me raporte hulumtuese dhe me pikëvështrime alternative mbi sferën publike përgjithësisht dhe në fushën ekonomike veçanërisht (preportr.cohu.org). Kjo qendër ka një bashkëpunim intensiv me qendra të ngjashme në rajon sidomos me Qendrën Rumune për Gazetari Hulumtuese, e njohur si një nga qendrat më të suksesshme në Evropën Juglindore.

Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi i realizuar (intervista dhe anketa).

Intervista

Për shkak të sigurimit të informacioneve kualitative në saje të punimit kemi intervistuar edhe personalitete nga stafi akademik, persona të shquar nga shoqëria civile dhe përfaqësues nga institucionet e ekzekutivit shtetëror, të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë për nga aspekti kualitativ i mbledhjes së të dhënave. Më poshtë do të shpalosim pyetjet dhe përgjigjet e personaliteteve të intervistuar.

Intervista 1: Safet Gerxhaliu

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Pavarësia e Kosovës do të ishte vetëm një utopi pa ndihmën dhe angazhimin e faktorit ndërkombëtar e në veçanti SHBA-ve, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe Francës. Është një akordim ndërkombëtar i pa parë sidomos pas luftës së dytë botërore dhe i mbështetur në aspektin human sidomos pas asaj që ndodhi në Bosnje dhe Hercegovinë, konkretisht në Srebrenicë ku ndodhi një masakër e pa imagjinuar për fundin e shekullit të XX.

2. Ne cilat segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar ?

Ndihmat e ofruara nga faktori ndërkombëtar duhet të analizohen në disa etapa kohore:

- Intervenimi ushtarak,
- Intervenimi human,
- Intervenimi emergjent,
- Stabiliteti para demokracisë,
- Zbatimi i Rezolutës 1244 të KB,
- Themelimi I INPV-ve,
- Standardet para statusit,

- Përgatitja për bartjen e kompetencave nga UNMIK- u tek Institucionet vendore,
- Stabiliteti politik,ekonomik dhe social,
- Proceset Integruese,
- Edukimi,
- Ndërkombëtarizimi etj.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore te Kosovës?

Shekulli XX dhe fillimi i shekullit të XXI bazohet në transferimin e KNOW-HOW dhe përvojave nga vendet e ndryshme të përfshira nën e ombrellën e Misionit të Kombeve të Bashkuara. Kjo ndihmë e krijimit te institucioneve vendore u realizua:

- Në formë direkte,
- Indirekte dhe
- Periferike.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënëse në Kosovën e pas luftës ?

Në ndërtimin e një shoqërie demokratike roli i OJQ-ëve është i pa kontestueshëm. Besoj që në këtë drejtim Kosova ka dëshmuar një tolerancë unike për shoqëritë moderne. Ajo që është shqetësuese është fakti se sa kanë qenë demokratike disa OJQ. Në një vend ku sundimi i rendit dhe ligjit është i vobektë është pikëpyetje se sa mund te kontrollohet funksionimi i këtyre OJQ-eve si dhe nga rrjedh financimi i tyre. Nga kjo rrjedhin edhe fenomene negative që ndikojnë në imazhin e Kosovës sepse shumë OJQ të pa kontrolluara e kanë dëmtuar imazhin e Kosovës duke e prezantuar atë në forma të ndryshme jo reale.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Vetë fakti që janë bartur kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale nga faktori ndërkombëtar tek institucionet vendore, dëshmon një monitorim dhe raportim pozitiv. Sa ka pasur vlerësim objektiv duhet analizë më e thuktë por e vërteta është se sistemi i drejtësisë dhe sundimi i rendit dhe ligjit janë dështimet më të mëdha.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë ?

Jam i mendimit se pritjet më të mëdha të qytetarëve të Kosovës kanë qenë nga misioni i EULEX-it por në të njëjtën kohë ka qenë edhe zhgënjimi më i madh. E them këtë duke u bazuar në faktin se ka qenë misioni më i madh i BE-se jashtë Evropës por edhe misioni më i shtrenjtë. Pritjet kanë qenë se do të ulet krimi dhe korrupsioni përmes kapjes se peshqve të mëdhenj të krimit të organizuar por u prodhuan vetëm spektakle:

- Është pritur se do të ketë luftë ndaj krimeve të luftës nga të gjitha palët por kjo nuk ndodhi,
- Është pritur të zgjidhet fati i të pa gjeturve të luftës por kjo dështoi,
- Është pritur rimëkëmbje ekonomike dhe hulumtim i procesit të privatizimit të kriminalizuar por kot.

Prandaj mund të quhet si mision i dështuar në çdo aspekt.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparenca, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre ?

Me dështimin e EULEX-it tek Institucionet tona u rrit:

- Burokracia,
- Nepotizmi,
- Meritokracia,
- Politizimi i skajshëm i Institucioneve,
- Rritja e ekonomisë së kriminalizuar dhe informalitetit ,
- Mungesa e llogaridhënies dhe e transparencës qoftë institucionale apo individuale.

Kjo është pasoja e mungesës së sundimit të rendit dhe ligjit.

8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Vetë fakti që nuk ka pastrim të listave dhe në Kosovë votojnë edhe të vdekurit është dështimi i parë. Mungesa e kamerave në qendrat votuese është një dukuri tjetër negative e këtij procesi. Mungesa e transparencës lidhur me financimin e kampanjave zgjedhore të partive politike është po ashtu një dukuri që e dëmton këtë proces dhe kuptohet mungesa e monitorimit dhe e përgjegjësisë institucionale e bëjnë jo kredibil këtë proces. Mungesa e alternativave përmes partive të reja është një fenomen negativ sepse edhe sot të kemi zgjedhje alternativat janë të njëjta që nga pas lufta.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Një shoqëri demokratike raportet ndëretnike duhet të ketë shtyllën e funksionimit të shtetit demokratik me aspirata për anëtarësim në familjen evropiane. Për fat të keq, në Kosovë pas luftës shumë më tepër është humbur kohë duke tentuar të zbukurohet e kaluara sesa të ndërtohet ardhmëria. Për avancim të raporteve ndëretnike duhet dialog konstruktiv institucional në rend të parë brenda Kosovës e më pastaj me vendet përreth. Në Kosovë ka ndodhur e kundërta. Është biseduar për marrëdhëniet ndëretnike në veçanti me serbët me Beogradin e jo me serbët në Kosovë. Janë politizuar këto marrëdhënie skajshmërisht që është mjaft e dëmshme për demokracinë. Aty ku ka politizim të pa kontrolluar ka edhe dukuri kriminale dhe ky është një realitet i hidhur i krijuar në Kosovë.

Më shumë flitet për normalizim e raporteve ndëretnike se sa që veprohet.

Korniza ligjore dhe kushtetuta e Kosovës janë shume te qarta por duhet vetëm kurajo për zbatim dhe implementim.

Intervista 2: Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, ish President i Republikës së Kosovës

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Pavarësia e Kosovës në radhë të parë është rezultat i sakrificës së popullit të saj përgjatë dekatave të shumtë. Ky flijim brezash së fundi mori artikulin më të mirë me rezistencën e fuqishme politike dhe të armatosur e cila kulmoj në dekadat e fundit të shekullit të kaluar. Po kështu duhet thënë se Pavarësia e Kosovës është edhe rezultat i ndihmës së pakursyer ndërkombëtare e cila ndihmë është shpërfaqur si në aspektin e mbështetjes politike ndërkombëtare, veçanërisht nga ana e SHBA – ve dhe e vendeve të rëndësishme të Bashkimit Evropian. Fundi i procesit që vie me Lirinë e Kosovës domosdo pasqyrohet më intervenimin ndërkombëtar nëpërmjet NATO-së e cila për 78 ditë rresht bombardoi caqet dhe infrastrukturën vrastare të Serbisë e cila kishte planifikuar zhbërjen e Kosovës dhe vrasjen me paramendim të popullit shumicë të saj – shqiptarëve.

2. Në cilat segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?

Janë shumë veprime të cilat janë ndërmarrë nga faktori ndërkombëtarë. Do të dalloja se në veprimin politik në nivele të ndryshme ndërkombëtarë janë nxjerrë një varg rezolutash gjatë viteve të nëntëdhjeta me të cilat janë dënuar veprimet shtypëse të sërabisë ndaj Kosovës. Rezoluta me peshë janë ato të mekanizmave të OKB-së që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Po kështu në nivel të Këshillit të Evropës ka pasur reagime. Nga shtetet veç e veç dallojmë qëndrimin decidiv të Presidentit të SHBA-ve George Bush në vigjilje të kërshëndellave të vitit 1992 se “Kosova paraqet vijën e kuqe e cila nuk mund të kalohej”. Ky ka qenë adresim për Serbinë e cila kishte filluar me agresionet në Kroaci dhe Bosnje dhe pritej që të hapte frontin jugor, pra të sulmonte Kosovën. Aspekti tjetër në këtë drejtim është procesi i madh bisedimeve në Rambujhe si dhe së fundi intervenimi i domosdoshëm ushtarak në Kosovë.

Kapitull i veçantë është veprimi i institucioneve ndërkombëtarë në Kosovë mbi bazë të Rezolutës së KS të OKB-së 1244 me qëllim të ringritjes së institucioneve demokratike dhe së fundi procesi i bisedimeve për statusin final të Kosovës gjer në pavarësim i ndërmjetësuar nga Emisari Special i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Ky rol mi ishte besuar z. Marti Ahtisaarit – ish president i Finlandës.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore te Kosovës?

Kanë ardhur në Kosovë misione të shumta dhe me detyra specifike. Këto njihen si UNMIK (Mision i OKB në Kosovë), në krye, me Përfaqësuesin Special të OKB-së në Kosovë. UNMIK ka pasur disa shtylla nëpërmjet të cilave ka zhvilluar veprimtarinë e vet. Pastaj ka vepruar OSBE-ja, Komisioni Evropian etj. Secili prej tyre ka pasur detyra specifike, duke filluar prej ngritjes së institucioneve të përkohshme, ajo për transformimin dhe zhvillimin e ekonomisë, ajo për sundimin e ligjit etj. Janë organizuar zgjedhjet për nivelin lokal dhe ato të përgjithshme.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënëse në Kosovën e pas luftës ?

Shoqëria civile në Kosovë nuk ka pasur traditë veprimi. Megjithatë ajo për aq sa ka qenë është angazhuar në shumë procese. Përfaqësuesit e saj kanë qenë pjesëmarrës në mekanizma të rëndësishëm veprues të kohës. Fatkeqësisht, jo rrallë pjesëtarë të shoqërisë civile janë përdorur si mbështetës të grupeve të caktuara civile.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfillt të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Di se ka pasur një monitorim aktiv të veprimit të institucioneve të sapoformuar dhe që vazhdojnë deri edhe me mbikëqyrjen e institucioneve. Kjo do të vazhdojë edhe pas shpalljes së pavarësisë, përkatësisht gjer në vitin 2012. Përkundër punës korrekte, herë herë ka pasur edhe zbrastësi në punën e tyre. Kjo është shprehur në mos angazhimin e bollshëm (bashkë me institucionet relevante të Kosovës) sidomos në fushën e sundimit të ligjit.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë ?

Mendoj se ka pasur mundësi të veprojnë në mënyrë më energjike. Siç thash edhe më herët, ka mungesa sidomos në fushën e këtij mekanizmi. Kam përshtypjen se nganjëherë me spektakle të panevojshme ka bërë reklamë veprimtarisë së tij, por që në realitet rezultatet e pritura kanë munguar.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparencja, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre ?

Nuk kam një pasqyrë të plotë të asaj se sa është transparencja e tillë në vendet e rajonit. Por sa i përket Kosovës, dua të besoj në raportet e progresit të KE për Kosovën. Ka rezultate, por ka edhe shumë për tu dëshiruar.

8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Karshi pritjeve dhe sfidave që na presin, mendoj se jo. Kam përshtypjen se gjeneratat e legjislaturave të dala në Kosovë, dallojnë shumë nga njëra tjetra. Fatkeqësisht në vend së të shtohet kualiteti, ai ka rënë. Gjuha e cila përdoret në foltore të Parlamentit është degraduar.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Absolutisht po. Kjo është hetuar që nga fillimi. Fatkeqësisht një pjesë e komunitetit serb është peng i politikave të Beogradit. Ata refuzojnë integrimin. E mira në gjithë këtë periudhë është se nuk ka pasur konflikte mbi baza etnike.

Intervista 3: Hajredin Kuçi

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Çështjet e hapura në Ballkan çdo herë kanë pasur vëmendjen ndërkombëtare gjatë historisë. Procesi i shpërbërjes së ish Jugosllavisë është si rezultat i rënies së komunizmit, respektivisht bllokut të Lindjes dhe rrjedhimisht edhe krijimi i shteteve të reja përfshirë edhe Kosovën.

Natyrisht në shpërbërjen e ish Jugosllavisë kanë pasur rol popujt që kanë jetuar aty por me mbështetje ndërkombëtare sidomos në fazat e luftës për pavarësi sikur në rastin e Kosovës. Edhe çlirimi i Kosovës por edhe Pavarësia e Kosovës mbajnë autorësinë e popullit të saj dhe të partnerëve ndërkombëtar si SHBA dhe UE. Qëndrueshmëria e paqes në rajon pa rol pozitiv ndërkombëtar është shume e brishtë dhe proceset mund të vonoheshin për të mos thënë nuk do të realizoheshin.

2. Në cilat segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?

Në radhë të parë, ndihma për mbijetese fizike të popullit në kohën e luftës, pastaj në ndërtimin e institucioneve dhe jetës demokratike në vend si dhe në segmente të sigurisë, rendit dhe ligjit si më të theksuara.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës?

Ne kemi pasur administratë ndërkombëtare në Kosovë nga viti 1999 me rol aktiv të UNMIK-ut në çdo sferë të jetës sonë. Pastaj EULEX në fushën e rendit dhe ligjit si dhe mbështetjen përmes projekteve tjera bilaterale të shteteve ose organizatave ndërkombëtarë.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënëse në Kosovën e pas luftës ?

Ndërtimi i demokracisë ka nënkuptuar edhe ndërtimin e shoqërisë civile si mbështetëse e demokracisë dhe si vrojtuese e veprimeve institucionale dhe politike në dobi të interesit publik. Natyrisht në faza të caktuara ka luajtur rol më të madh por duhet pranuar se kyçja e disa aktorëve të shoqërisë civile e ka dëmtuar autoritetin e shoqërisë civile si dhe interesimi për projekt më shumë se sa për qellim. Duhet konstatuar se është ndërtuese por edhe përgjegjëse e ndërtimit të demokracisë sipas fuqisë që ka pasur.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Raportet kanë treguar gjendjen por edhe mundësinë për të reflektuar për dobësitë. Raportet që janë publikuar janë përdorur si mjete kundërshtimi të bartësve të institucioneve dhe kur ato kanë pasur fuqinë e atraktivitetit edhe për të përmirësuar gjendjen.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë ?

Roli ka qenë në krijimin e ambientit për rend dhe ligj dhe ngritjen e kapaciteteve si dhe vet komponentët ekzekutive. Suksesi është i tyre por edhe i Kosovës apo edhe dështimi. Pritjet kanë qenë më të mëdha por edhe premtimet e tyre.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparencja, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre ?

Kosova nuk është shumë dalluese në raport me fqinjët në traditën dhe kulturën qeverisëse për transparencë. Mekanizmat ndërkombëtar që kanë administruar në Kosovë dhe monitorimi më i rreptë ka detyruar të jenë më transparente për çka edhe janë ndërtuar mekanizma adekuat. Natyrisht kur janë prekur interesat politike dhe është anashkaluar ky parim por prapë ka mbetur më e mirë se në vendet përreth.

8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Sistemi zgjedhor dhe funksionimi i mirëfilltë i demokracisë dhe institucioneve ka ndodhur pas pavarësisë në veçanti pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare. çdo palë zgjedhje kanë ndikuar në heqjen e frustrimeve elektorale dhe ballafaqim me realitetin si dhe në pafuqinë e partive për të realizuar premtimet si dhe humbjen e mundësive të fajësimit të tjerëve. Pas çdo përfundimi i misionëve ndërkombëtarë vitet e para janë më sfiduese për institucionet dhe kjo u pa edhe në Kosovë pas vitit 2012. Zgjedhjet japin kontribut në përgjegjësinë e të zgjedhurve por edhe në stabilitet institucional pa ndikime nga të zgjedhurit politik.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë kanë dy qasje në pjesën ku ushtrohet sovraniteti dhe në pjesën ku më pak ushtrohet sovraniteti. Në pjesën e parë në veçanti me jo-serbët janë korrekt dhe integruese ndërsa me serbet në vitet e fundit me të tensionuara në veçanti në pjesën veriore të

Kosovës dhe me ndikim nga Beogradi. Duket se serbet nuk e duan Beogradin por nuk i besojnë ende Kosovës. Këtu duhet të jemi më integruës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjë presion në Beograd që të mos i përdor si pikë konfrontimi por si urë bashkëpunimi. Raportet Kosovë-Serbi ndikojnë direkt në raportet ndëretnike brenda Kosovës.

Intervista 4: Jakup Krasniqi

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Sikur politika shqiptare pas Konferencës Ndërkombëtare të Rambujesë të ishte më unifikuuese, mbase edhe ka pasur mundësi të kishte një zhvillim tjetër për Pavarësinë e Kosovës. Pas Qershorit 1999 e sidomos pas caktimit për Kryeadministrator të UNMIK-ut të Bernard Kuchner-it, para krijimit të institucioneve të përbashkëta të UNMIK-ut me Kosovën, Kushneri me Ambasadorin Hollbruk kanë kërkuar që faktori politik i Kosovës (LDK, LBD dhe krahu i luftës) të formonin një qeveri të përbashkët që ajo të njihet nga Komuniteti Ndërkombëtar. Faktori politik shqiptar nuk u mor vesh dhe kështu u bë një qeveri e përbashkët që në fakt roli i UNMIK-ut ishte vendimtar. Sikur të formohej qeveria e përbashkët, ndoshta pavarësia e Kosovës do të kishte një rrugëtim tjetër. Pasi nuk u arrit kjo, rruga që u vazhdua e bëri të domosdoshëm ndihmën dhe koordinimin me faktorin ndërkombëtar. Pa këtë koordinim, Kuvendi i Kosovës edhe do të mund ta shpallte Pavarësinë e Kosovës, por rruga e njohjeve do të ishte shumë më e vështirë sesa është tani. Shkurt, ndihma e Komunitetit Ndërkombëtar ishte e domosdoshme.

2. Në cilat segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?

Komuniteti Ndërkombëtar, në mënyrë më serioze për zgjedhjen e statusit të Kosovës ka filluar të mendojë pas ngjarjeve të 15, 16 e 17 Marsit 2004. Pas këtyre ngjarjeve OKB e ngarkon Kai Aiden për të bërë një Raport për Kosovën, i cili Raport thoshte së status-quo-ja nuk mund të vazhdonte më. Pas këtij Raporti Sekretari i Përgjithshëm i OKB e cakton ish Presidentin e Finlandes, Marti Ahtisarin dhe zëvendësin e tij austriakun Robert Rohanin për t'i udhëhequr Bisedimet e Vjenës. Në këtë çështje kontributin e tij e ka dhënë edhe Grupi i Kontaktit ku bënte pjesë edhe Rusia, i cili me Deklaratën e 31 janarit 2006 i jep orientimet se nga duhet të zhvillohet procesi për përfundimin e Statusit të Kosovës. Në atë Deklaratë në mes të tjerave thuhej: a) Kosova nuk ka kthim para marsit 1999; b) Kosova nuk mund të bashkohet me ndonjë shtet tjetër dhe c) Kosova nuk mund të bashkohet me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Mbi bazën e kësaj deklarate janë zhvilluar Bisedimet e Vjenës të cilat Bisedime kanë përfunduar me Dokumentin Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës. Pra ndihma e Komunitetit Ndërkombëtar ka qenë e gjithanshme; politike, profesionale e diplomatike si edhe në fushën e sigurisë.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës?

Komuniteti Ndërkombëtar ka dhënë një ndihmë të gjithanshme në ndërtimin e institucioneve në Kosovën e pas luftës. Në aspektin juridik kjo ndihmë ka ardhur që me miratimin e Kornizës Kushtetuese dhe Rregulloreve të UNMIK-ut e deri te Kushtetuta e Kosovës. Pra ndihma më e madhe është dhënë në segmentin e sigurisë (KFOR-i), në Sistemin e Drejtësisë, të SHPK-së (Shërbimit Policor të Kosovës), të Demokratizimit (OSBE-ja) dhe krijimit të Financave Publike (Buxheti i Konsoliduar i Kosovës). Ndhmë është dhënë edhe në Procesin e Privatizimit, por në këtë rrafsh ky Proces ka filluar e ka vazhduar me defekte të shumta, pasojat e të cilit i shohim edhe sot e kësaj dite. Pasoja shohim, sidomos edhe në Sistemin e Drejtësisë, i cili as sot e kësaj dite nuk është profesional, nuk është funksional e as kredibil.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënese në Kosovën e pas luftës ?

Shoqëria civile është përpjekur që të kontribuoj përmes mbikëqyrjes në ndërtimin e institucioneve të shtetit, por në këtë rrafsh, institucionet e shtetit as sot e kësaj dite nuk shquhen për kredibilitet e llogaridhënie. Kredibilitetit e llogaridhënies duhet t'i kushtojmë edhe në të ardhmen një kujdes të madh.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Raporte ka pasur goxha shumë dhe të cilat në të shumtën e rasteve i kanë evidentuar të metat e dobësitë, por zhvillimi i mirëfilltë i institucioneve shtetërore të Kosovës len për të dëshiruar më shumë.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë ?

Nga EULEX-i kam pritur më shumë, për faktin se ka qenë një trup i BE-së. Sigurisht që ka eliminuar ndonjë sjellje devijante, por edhe në kohët e tij ka pasur devijime, deri edhe profesionale. Ndonëse EULEX-i kishte kompetenca ekzekutive në Drejtësi, Siguri e Dogana, këto segmente edhe sot e kësaj dite kanë dobësi e sidomos dobësitë kanë mbetur në Sistemin e Drejtësisë.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparenca, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre ?

Sa i përket kësaj çështjeje, edhe Kosova është aty afër me vendet e rajonit tonë. Por ne për shkak edhe të mos njohjes ndërkombëtare do të duhej të ishim shembull për transparenca, llogaridhënie dhe sundim të rendit e të ligjit.

8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Zgjedhjet e lira në Kosovë, nëse bëhet një krahasim me legjislativat e para dhe këto të pas Pavarësisë, për nga cilësia e përfaqësimit kemi pasur një rënie të vazhdueshme. Mbase për këtë fajin duhet kërkuar edhe të sistemi zgjedhor me lista të hapura dhe me mundësinë e zgjedhjes së më shumë se një kandidati. Bindja ime është se sistemi zgjedhor me lista të hapura e me mundësi të votimit pesë kandidat e ka dëmtuar shumë cilësinë e zgjedhjeve. Madje kërkesa për lista të hapura ka ardhur nga shoqëria civile. Sistemi zgjedhor duhet të ndryshojë. Pa zgjedhje të lira, të drejta e kredibile, është vështirë të ndërtohen institucione demokratike dhe për pasojë as shtetit të së drejtës.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Sa u përket të drejtave dhe lirive të komuniteteve pakicë, Kosova ka vendosur standardin më të lartë në Evropë. Me këto të drejta që i kanë komunitetet pakicë, e sidomos komuniteti serb, vërtetë etnitë do të duhej të ishin faktor stabiliteti, sikur politika e Beogradit mos t'i shihte e trajtonte komunitetin serb të Kosovës si “mish për top”.

Intervista 5: Prof. Dr. Arsim Bajrami.

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Pavarësia e Kosovës paraqet projektin më të rëndësishëm të faktorit ndërkombëtar në tre dekadat e fundit. Kosova nuk do të gëzonte pavarësinë e njohur ndërkombëtarisht pa mbështetjen e SHBA-ve dhe BE për një periudhë të gjatë. Lufta e UÇK-së ndonëse e drejtë, nuk do të rezultonte me pavarësinë e Kosovës pa mbështetjen ndërkombëtare dhe bombardimet e NATO-s. Kosova ka shpallur pavarësinë e koordinuar sipas Planit të Ahtisarit dhe pavarësia e saj është konfirmuar me vendimin e GjND-se.

2. Në cilët segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar ?

Ndihma ndërkombëtare ka qenë shumëdimensionale dhe ka përfshirë këto segmente; 1. Shtet ndërtimi; 2. Siguria dhe paqja; 3. Nxjerrja e Kushtetutës dhe legjislacioni organik; 4. Ndërkombëtarizimi, njohjet dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare; 5. Zhvillim ekonomik; 6. Sundimi i ligjit dhe ndërtimi i sistemit gjyqësor; 7. Ndërtimi i sistemit të sigurisë në Kosovë dhe ngritja e FSK-se; 8. Dialogu me Serbinë dhe përpjekja për një Traktat të Pages; 9. Procesi i njohjeve të Kosovës; 10. Zgjidhja e krizave të brendshme politike..

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore te Kosovës?

Kjo është realizuar përmes angazhimit direkt dhe përmes ekspertëve ndërkombëtar që kanë asistuar në shtet-ndërtim, hartim të kushtetutës dhe legjislacionit.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënëse në Kosovën e pas luftës ?

Roli i shoqërisë dhe OJQ-ve ka qenë kontrovers si pasojë e asaj se shoqëria civile më tepër i ka shërbyer konjunkturave politike, se sa demokratizimit të shoqërisë kosovare. Në Kosovë akoma nuk kemi një shoqëri civile aktive dhe të përkushtuar në monitorimin e pushtetit dhe qeverisjes. Edhe shoqëria civile ka përgjegjësi në vonesën e tranzicionit demokratik në Kosovë.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Një rol të veçantë në këtë drejtim kanë luajtur ambasadat e vendeve mike e sidomos amerikane që ka ndihmuar leadershipin në zgjidhjen e krizave politike. Jo gjithëherë ky ndikim ka qenë pozitiv

sepse aty këtu ka pasur qasje korruptive ndërkombëtare dhe involvim të palejueshëm dhe anim politik.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë?

Eulex dhe UNMIK janë dy misione të dështuara në Kosovë. UNMIK ka dështuar të zgjidhë statusin final të Kosovës, kurse EULEX ka dështuar të ndërtojë shtetin ligjor dhe të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar ne Kosovë. EULEX po ashtu dështoi të gjykojë krimet e luftës në Kosovë. Këto dy misione kanë përgjegjësi para OKB dhe BE për dështimin e tyre dhe misione të tilla asnjëherë nuk duhet të përsëriten në shtetet e post-konfliktit.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore te Kosovës për nga transparenca, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre?

Kosova ka dështuar të ndërtojë një sistem të qeverisjes së mirë, dhe një demokraci të qëndrueshme funksionale. Parimi i transparencës ekziston vetëm formalisht, nuk ka llogaridhënie për dështimet politike dhe kualitetin e shërbimeve publike qe i ofrohen qytetareve.

Lidershipi, partitë politike nuk kanë arritur të dalin jashtë konjunkturave klanore dhe partiake dhe nuk kane ndërtuar politika publike në interes të shtetit dhe qytetarëve. Kjo ka ndikuar në ngecjet e Kosovës në konsolidimin e saj shtetëror dhe demokratik.

8. Zgjedhjet ne Kosove a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Kosova ka dështuar te ndërtojë një sistem adekuat dhe efikas zgjedhor. Në këtë kontekst kemi një kthim prapa në raport me standardet e arritura më herët sepse çdo legjislaturë e re ka qenë më e dobët profesionalisht dhe politikisht se ajo paraprake. Janë krijuar kriza të panevojshme politike dhe ka pasur vonesa në ndërtimin e institucioneve kushtetuese. Për këtë nuk ka qenë fajtores Kushtetuta, por mungesa e kulturës politike dhe shtetërore të lidershipit dhe partive politike.

9. A mund te konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti ne Kosovë?

Marrëdhëniet ndëretnike janë në nivel të kënaqshëm, duke përjashtuar destruktivitetin e komunitetit serb i cili në vazhdimësi ka krijuar kriza politike dhe ka qenë instrument i Beogradit në destabilizimin e Kosovës. Komunitetet tjera kanë treguar lojalitet dhe janë integruar në shoqërinë kosovare.

Intervista 6: Prof. Dr. Ylber Sela

1. A mendoni se do të realizohej Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar nuk do të mundeshe të realizohet, për shkak të rrethanave të cilat lidhen me drejtën ndërkombëtare dhe aspektin e transformimit të konfliktit të armatosur në tryezën e bisedimeve.

2. Në cilët segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?

Ndihma e faktorit ndërkombëtar ka qenë e pranishme në të gjitha fushat e funksionimit institucional të Kosovës së pasluftës. Këtu mund të veçohet si më e rëndësishme ndihma e ofruar në fushën politike, ushtarake dhe humanitare.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës?

Ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore të Kosovës është realizuar nëpërmjet ndërtimit të institucioneve shtet-formuese në vend, edhe atë përmes programeve speciale të OSBE, UNMIK dhe USAID-it, të cilët nëpërmjet burimeve të tyre njerëzore i ri-themeluan institucionet shtetërore të Kosovës.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënëse në Kosovën e pas luftës ?

Faktori ndërkombëtar ka stimuluar shumë OJQ dhe shoqërinë civile, e cila ka pasur një rol të rëndësishëm dhe ka marrë pjesë në vendimmarrjet dhe projektet institucionale në ndërtimin e institucioneve të Kosovës.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë kanë pasur ndikim të madh. Pa monitorimin ndërkombëtar Kosova nuk do ta kishte këtë progres që e ka sot.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë?

EULEX-i ka kontribuar shumë pozitivisht duke ndërtuar dhe kontribuar që sot disa institucione të funksionojnë me një sistem evropian.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore të Kosovës për nga transparenca, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre?

Për sa i përket transparencës, llogaridhënies po edhe ndëshkueshmërisë, Kosova qëndron më mirë dhe dallon nga fqinjët, dhe kjo falë ndikimit dhe rolit të faktorit ndërkombëtar.

8. Zgjedhjet në Kosovë a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Po. Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor ka pasur sukses dhe është më i avancuari në rajon. Kjo nënkupton se kapacitetet shtetërore të cilat menaxhojnë me këtë operacion të ndërlikuar kanë krijuar nivele dhe standarde bashkëkohore, gjë e cila nuk është e rastit në vendet tjera të Ballkanit perëndimor.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Marrëdhëniet ndëretnike janë një komponentë e rëndësishme për stabilitetin e Kosovës. Integrimi i pakicave dhe të drejtat e tyre bëjnë që Kosova si shtet multietnik të jetë në harmoni me etniteteve, përveç serbeve të cilët edhe më tej dirigjohen nga Beogradi dhe shpesh paraqiten tendenca për ta prishur këtë harmoni.

Intervista 7: Nazmi Maliqi

1. A mendoni se do të realizohet Pavarësia e Kosovës pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar?

Tendencat degraduese serbe ndaj Kosovës ishin intensive qysh nga viti 1981, por në vitet 1989-1990 merr trajtën e rrënimit të plotë të dhunshëm të pozitës kushtetuese të Kosovës, e cila ishte element konstitutiv i ish-federatës Jugoslave dhe dy milion shqiptarë të Kosovës u nxorën me dhunë jashtë ligjit nga pushteti i instaluar serb. Sundimin e Serbisë në këtë periudhë e karakterizojnë: suprimimi i statusit konstitutiv në federatën jugosllave që kishte Kosova dhe bllokimi i plotë i veprimtarisë legale të mëvetësisë së saj; vendosja e të ashtuquajturave masa të jashtëzakonshme e të dhunshme; dëbimi i plotë i shqiptarëve nga jeta publike; dëbimi masiv i shqiptarëve nga puna, nga administrata nga jeta e përgjithshme institucionale, bllokimi i të gjitha institucioneve arsimore e shkencore, duke filluar nga shkollat e fakultetet e deri te Akademia e Shkencave; terrori i përditshëm e sistematik. Shqiptarët kanë shumë arsye të besojnë se të gjitha këto masa të Serbisë janë në funksion të dëbimit të tyre dhe të ndërrimit të strukturës etnike të Kosovës.

Fakti se çështja e **Kosovës është çelës për stabilizimin e Ballkanit**, Pavarësia e Kosovës u trajtua me poziten gjeostrategjike e Kosovës dhe kryqëzimet aktuale të natyrës politike, ekonomike dhe kulturore, bënë që qetësia në Ballkan të varet edhe nga shkalla e angazhimit të këtyre shteteve në stabilizimin e gjendjes në Kosovë. Me siguri pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar, do të ishte vështirë të realizohet pavarësia e Republikës së Kosovës.

2. Në cilët segmente apo fusha ka qenë kjo ndihmë e ofruar?

Diplomacia dhe forcat ushtarake amerikane në Kosovë ofruan siguri të brendshme dhe regjionale me shtetet për rreth. Shqiptarët kudo që jetojnë t'i evitojnë dukuritë që cenojnë imazhin ndërkombëtar të Kosovës. Intervenimi humanitar i NATO-s mbi forcat pushtuese serbe, me përkrahje të Bashkësisë ndërkombëtare të udhëhequr nga diplomacia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i dhanë kuptim paqes dhe pavarësisë të shtetit të Kosovës.

3. Në çfarë mënyre është realizuar ndihma institucionale në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore te Kosovës?

Pa mëdyshje se SHBA-të dhe NATO, janë bartëse të aktiviteteve diplomatike për rrethanat e ruajtjes së paqes në Kosovë.

Në zgjidhjen e konfliktit shqiptaro - serb në Kosovë, prej presionit ekonomik, presionit politik dhe diplomatik dhe gjer te bombardimet e para nga aviacioni luftarak i NATO-s, mbi caqet ushtarake dhe policore serbe në Beograd dhe në qytetet e tjera.. Si faktor kryesor në skenën ndërkombëtare bënë presion të arsyeshëm ndaj Beogradit duke filluar me mosnjohjen e subjektivitetit të RSFJ-së, për shkak të Kosovës. Për zgjidhjen e situatës në Kosovë, akoma janë evidente angazhimet, kjo i detyron të gjithë kosovarët dhe shqiptarët në përgjithësi, të kuptojnë drejtë këta angazhime pa të cilat do të ishte shumë vështirë, që mos të them edhe i pamundshëm çlirimi i Kosovës nga okupatori serb dhe forcat ushtarako-policore serbe.

4. Cili ka qenë roli i shoqërisë civile dhe i OJQ-ve në Kosovë në ndërtimin e institucioneve kredibile dhe llogaridhënese në Kosovën e pas luftës ?

Politika kosovare patjetër duhet të inkorporohet në esencën e kuptimit të drejtë të shoqërive civile, duke e ndërtuar filozofinë e guximshme të mëvetësisimit. Avancimi i çështjes kombëtare në paqe mund të arrihet me projekte, me konkurrencë arsimore, akademike, që mund të kalojnë në një konkurrencë reale, duke i respektuar të gjitha normat ligjore.

Nëse bazohemi në shtyllat kryesore për shtetbërje, duke filluar prej normave dhe përcaktimit kushtetues, formimin e institucioneve shtetërore, formulimin e politikave publike, zbatimin e këtyre politikave shtetërore, dhe shtylla e pestë kontrolli demokratik i institucioneve shtetërore dhe llogaridhënia, kredibiliteti i llogaridhënies në Kosovë mbetet nën nivelin e dëshiruar.

5. Sa kanë ndikuar raportet relevante të institucioneve monitoruese në zhvillimin e mirëfilltë të institucioneve shtetërore në Kosovë?

Këto lëvizje pa mëdyshje do të krijojnë vetëbesim dhe impuls të ri të demokracisë politike, si faktor ndikues në ndërtimin e institucioneve shtetërore. Në këtë kontekst gjithëherë të afirmohen dhe të sigurohen të drejtat e njeriut dhe liritë e qytetarëve, sidomos nëse dëshirohet të arrihet legjitimitet me rezultatet zgjedhore, duke i respektuar normat, që i ofron jeta politike në pluralizëm si bazë elementare e kultivimit të vlerave demokratike. Këto rregulla nuk lejojnë

hapësirë për krijimin e koncepteve, të krijimit të koalicioneve marksiste leniniste dhe komuniste, duke u shtirur për unitet kombëtar dhe në platforma gjoja kombëtare, duke u thirrur për unitet kombëtar dhe me promovime falco të mbrojtjes së çështjes kombëtare.

Avancimi i çështjes shqiptare në paqe mund të arrihet me projekte, që mund të kalojnë në një konkurrencë reale, duke i respektuar të gjitha normat e procedurës zgjedhore, duke filluar prej: ndarjes reale të njësisve zgjedhore, caktimit të vendvotimeve duke e respektuar shtrirjen dhe numrin e zgjedhësve, shpalljes së kandidaturave dhe të drejtës për kandidim, rregullat e definuara në fushatën zgjedhore me programet parazgjedhore, procedurat e votimit, përgjegjësia e këshillave zgjedhore në respektimin e ligjit, gjer në shpalljen e rezultateve zgjedhore dhe pranimin e rezultateve nga partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje.

6. Cili ka qenë roli i EULEX-it dhe i institucioneve tjera ndërkombëtare në parandalimin e sjelljeve devijante në institucionet shtetërore në Kosovë?

Në rrethanat e tanishme sociale, ekonomike, të sigurisë e të stabilitetit të brendshëm, duke analizuar kronologjinë e bashkëpunimit me UNMIK-un, me forcat e KFOR-it EULEXSIN dhe OSBE-së në Kosovë duhet të precizohet edhe harta politike e Kosovës.

Të kuptohet drejtë se pavarësia e Kosovës, duke e pasur parasysh pozitën gjeostrategjike, gjeografike dhe gjeopolitike dhe rolin e rëndësishëm që e ka Kosova në regjion. Prezenca e NATO-s, apo zgjerimi i NATO-s , në krahun jugor do të jetë imperativ kategorik i kohës, që popujt e regjionit të ndiejnë veten të sigurtë dhe të merren me probleme që mund të ofrojnë konsensus në zgjidhjen e atyre problemeve, që gjer më tani janë vlerësuar si të pazgjidhshme.

7. Si qëndrojnë institucionet shtetërore te Kosovës për nga transparenca, llogaridhënia, dhe shërbimet në krahasim me fqinjët e tyre?

Me këtë do të krijohen kushte, për hapjen e shtigjeve në gjetjen e mekanizmave që do ta bëjnë të frytshëm dialogun e Republikës së Kosovës me Serbinë dhe shtetet tjera ballkanike, e në këtë rast duke kuptuar drejtë vullnetin e popullit të Kosovës.

Politika e udhëhequr nga politikan demokrat, krijon hapësirë të kuptueshme për një rend demokratik dhe një shkallë me të lartë, të kuptueshmërisë së qytetarëve ndaj tyre. Qytetarët do të

kenë shkallë më të lartë të tolerancës ndërnacionale, ndërfetare, tolerancë kulturore dhe do të ngritet edhe niveli i bashkëpunimit.

Pra, tani ka nevojë të pakontestueshme, të aktivizohet rëndësia e aktivitetit politik dhe dialogut, duke e shfrytëzuar potencialin intelektual, shkencor, politikë dhe nivelin kulturor të njerëzve, që këto bisedime t'i bëjnë transparente duke e mbajtur nivelin e përgjegjësisë, sepse këto bisedime do të ndiqen dhe do të ndërmjetësohen nga diplomat të cilët dëshirojnë që kjo pjesë e Ballkanit mos të jetë më brengë e SHBA-së dhe BE-së.

Këta veprime do të eliminojnë ndoshta **një logjikë të mbrapshtë, të psikologjisë konfliktuale**, që e promovuan këto vite aktorët me politika antishqiptare, duke harruar faktin se shqiptarët, serbët dhe popujt e Ballkanit, në këto hapësira gjeografike janë të ndërvuar me tokën ku jetojnë, që nuk mund të jenë edhe aq shumë të ndarë. Prandaj këto psikologji politike konfliktuale, duhet t'i menaxhojnë njerëz që me aftësinë, që e posedojnë vetëkontrollin dhe dimensionin e përgjegjësisë morale dhe ndërgjegjes personale.

8. Zgjedhjet ne Kosove a kanë avancuar cilësinë e institucioneve shtetërore?

Kosova ka nevojë të pakontestueshme për përfaqësues, që do të dalin nga zgjedhjet legjitime, për krijimin e kushteve normale për ndërtimin e shtetit, me institucione stabile dhe krijimin e kushteve institucionale për llogaridhënie. Me këtë, institucionet kosovare, partitë politike, shoqatat joqeveritare dhe të tjerët mbetet që të kenë kujdes të posaçëm për të drejtën zgjedhore, që të jenë konform rregullave dhe standardeve demokratike, si kusht prioritar për legjitimitimin e sistemit politik. Strukturat partiake në Kosovë që pretendojnë të jenë serioze u mbetet që të bëjnë orvatje që përbrenda strukturave të tyre të sqarojnë domosdoshmërinë që vetëm përmes zgjedhjeve demokratike mund të ndërtojnë shoqërinë plurale demokratike, ekonominë e tregut, të kontribuojnë në stabilitet të qëndrueshëm dhe të bëjnë pjesë aktive në proceset civilizuese, që janë të lidhura ngushtë edhe me interesin nacional të popullit të Kosovës.

9. A mund të konsiderohen marrëdhëniet ndëretnike si faktor stabiliteti në Kosovë?

Populli dhe institucionet në Kosovë, duhet t'i përjashtojnë të gjitha dilemat se u mungon gatishmëri për tolerancë politike, nacionale, fetare dhe të bindet faktori ndërkombëtar, se shqiptarët e Kosovës kanë potencial politik për udhëheqje dhe për organizim të të gjitha niveleve dhe segmenteve, për një Kosovë të pavarur. Me aktivitete konkrete, të krijohet besimi edhe te

shtetet fqinje edhe në njëfarë mënyre edhe të pengohen, ata që edhe më tej të përfitojnë në kurriz të Kosovës.

Këta angazhime për gjetjen e vlerave të përbashkëta në mes shqiptarëve dhe etnive të tjera në Kosovë, me siguri se do të ndodhin apo edhe do të konkretizohen, atëherë kur fillojnë dy taboret, shqiptarë dhe serbët dhe të tjerët të kuptojnë drejtë, se ky shtet nuk mund të jetë stabil nëse nuk respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, nëse nuk ndërtohet shteti juridik dhe nëse elitat e tyre politike injorohen në mes veti, apo edhe nëse ekziston edhe injorim politik edhe brenditë e tyre nacionale.

Afirmimi i projekteve të qëndrueshme në ndërtimin e ardhmërisë apo perspektivës nacionale, kulturore, politike, ekonomike të shtetit. Duke iu shmangur idesë së miteve, në këtë drejtim edhe duhet të hulumtohen vlerat e përbashkëta, nga se ato janë ekzistuese dhe të vërteta, ndërsa mitet janë inekzistente apo edhe të shpikura. Vlerat e përbashkëta në këtë rast në mes popullit shqiptar dhe etnive të tjera në Kosovë, nëse kanë vendosur të jetojnë në shtetin e përbashkët, është bashkëjetesa duke e respektuar tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Por, është më se e qartë se vlerat e përbashkëta nuk mund të imponohen me forcë dhe represion, por mbi të gjitha këta vlera ndërtohen nëse ekziston drejtësia dhe shteti juridik.

Konkluzione për intervistat e realizuara

Sipas intervistave të realizuara me njerëz me ndikim në rrafshin akademik dhe politik, të cilët në të njëjtën kohë janë njohës të mirë të rrethanave në Kosovë, e veçanërisht me temën në fjalë, mund të shohim një konvergjencë të madhe në mendime. Më poshtë do të përmendim pikat e përbashkëta dhe do të japim një përmbledhje të mendimeve të personaliteteve të intervistuar.

Të gjithë personalitetet e intervistuar kanë mendimin se roli i faktorit ndërkombëtar është jetik në pavarësinë e Kosovës dhe në zhvillimet institucionale në Kosovë. Të gjithë pajtohen se pavarësia e Kosovës do të ishte e pamundur ose do të vonohej shumë, pa ndikimin direkt ose indirekt të ndërkombëtarëve. Mirëpo, nga ana tjetër mendimet janë të ndryshme se si ka qenë ky ndikim në aspektin e ngritjes institucionale të Kosovës. Një pjesë e madhe e të intervistuarve ndajnë mendimin se UNMIK-u dhe EULEX-i kanë mundur të kenë ndikim shumë më pozitiv dhe se pritjet kanë qenë të mëdha ndërsa realizimi ka qenë shumë i dobët, bile edhe me elemente korruptive të ndërkombëtarëve. Kritikë më të mëdha janë mu në këtë sferë, në sundimin e të drejtës dhe ligjit, dhe luftën ndaj kriminalitetit dhe korrupsionit.

Në këtë vijë, të intervistuarit gjithashtu shprehen se shoqëria civile dhe OJQ-të, gjithashtu nuk kanë qenë në nivel të pritjeve dhe përgjegjësi. Përderisa një pjesë e personaliteteve kritikojnë mjaftë politizimin e OJQ-ve si dhe akuzojnë ata se disa prej tyre kanë agjenda të dyshimta, duke dëmtuar imazhin e Kosovës, disa prej personaliteteve arsyetojnë ngecjen e shoqërisë civile për shkak se është mjaftë e re dhe në ndërtim e sipër.

